



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.legjislacionishqiptar.gov.al

www.qpz.gov.al

Nr.130

8 gusht

2008

P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Vendim i KM nr.1081, datë 11.6.2008	Për hapjen e programit të studimit specializues afatgjatë, për mjekësi interne, pranë Fakultetit të Mjekësisë të Universitetit të Tiranës, dhe për miratimin e kuotave të pranimit në këtë program për vitin akademik 2007-2008 5727
Vendim i KM nr.1085, datë 23.7.2008	Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Selitë të qarkut të Lezhës 5727
Vendim i KM nr.1086, datë 23.7.2008	Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të bashkisë Cërrik të qarkut të Elbasanit 5728
Vendim i KM nr.1088, datë 23.7.2008	Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Gur i Zi të qarkut të Shkodrës..... 5730
Vendim i KM nr.1090, datë 2.7.2008	Për një ndryshim në vendimin nr.561, datë 16.8.2006 të Këshillit të Ministrave “Për pagat sipas gradave për punonjësit, oficerë dhe nënoficerë, të Gardës së Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.. 5731
Vendim i KM nr.1091, datë 2.7.2008	Për një ndryshim në vendimin nr.455, datë 18.7.2007 të Këshillit të Ministrave “Për pagat dhe shtesat mbi pagë të punonjësve të shërbimit pyjor” 5732
Vendim i KM nr.1092, datë 2.7.2008	Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të punonjësve të doganave 5733
Vendim i KM nr.1093, datë 2.7.2008	Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të punonjësve të sistemit tatimor 5736

Vendim i KM nr.1095, datë 2.7.2008	Për disa ndryshime në vendimin nr.194, datë 22.4.1999 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strukturës së pagës së punonjësve mësimorë, në arsimin parauniversitar”, të ndryshuar..	5739
Vendim i KM nr.1096, datë 2.7.2008	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.438, datë 13.7.2007 të Këshillit të Ministrave “Për pagat e punonjësve të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit”	5741
Vendim i KM nr.1097, datë 2.7.2008	Për një ndryshim në vendimin nr.366, datë 14.6.2006 të Këshillit të Ministrave “Për pagat e punonjësve të Policisë së Burgjeve”, të ndryshuar	5742
Vendim i KM nr.1100, datë 30.7.2008	Për miratimin e planit afatmesëm të veprimit të programit “Brain Gain”, për periudhën 2008-2009	5743
Vendim i KM nr.1106, datë 30.7.2008	Për miratimin e strukturës së pagës së punonjësve të Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara.....	5744
Vendim i KM nr.1108, datë 30.7.2008	Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluatjshme shtetërore, të cilat kalojnë në pronësi të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes sh.a.....	5744
Vendim i KM nr.1109, datë 30.7.2008	Për sigurimin e punonjësve, të punësuar në veprimtarinë minerare, nga aksidentet në punë	5749
Vendim i KM nr.1110, datë 30.7.2008	Për cilësinë e lëndës djegëse diezel, të prodhuar nga rafinimi i naftës bruto, vendase	5750
Vendim i KM nr.1111, datë 30.7.2008	Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Libonik të qarkut të Korçës	5751
Vendim i KM nr.1114, datë 30.7.2008	Për disa çështje në zbatim të ligjeve nr.7703, datë 11. 5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, nr.9136, datë 11.9.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe nr.7870, datë 13.10.1994 “Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar	5752
Vendim i KM nr.1115, datë 23.7.2008	Për miratimin, në parim, të marrëveshjes së financimit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Spanjës, në kuadër të programit “Një OKB”, për projektin “Qeverisje ekonomike, reforma rregullatore, pjesëmarrje e publikut, si dhe zhvillimi pro të varfërve, në Shqipëri”.....	5759
Vendim i KM nr.1116, datë 31.7.2008	Për lejimin e kalimit transit të tre autokolonave ushtarake italiane, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë	5760
Vendim i KM nr.1117, datë 31.7.2008	Për lejimin e kalimit transit të dy automjeteve ushtarake italiane, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë	5761
Vendim i KM nr.1118, datë 2.7.2008	Për një ndryshim në vendimin nr.839, datë 11.12.2003 të Këshillit të Ministrave “Për pagat e ushtarakëve aktivë të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar	5762
Udhëzim i MF nr.17/1, datë 5.8.2008	Për një ndryshim në udhëzimin nr.17, datë 13.5.2008 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”.....	5764

VENDIM
Nr.1081, datë 11.6.2008

**PËR HAPJEN E PROGRAMIT TË STUDIMIT SPECIALIZUES AFATGJATË, PËR
MJEKËSI INTERNE, PRANË FAKULTETIT TË MJEKËSISË TË UNIVERSITETIT TË
TIRANËS, DHE PËR MIRATIMIN E KUOTAVE TË PRANIMIT NË KËTË PROGRAM PËR
VITIN AKADEMIK 2007-2008**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 42 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Hapjen e programit të studimit specializues afatgjatë, për mjekësi interne, pranë Fakultetit të Mjekësisë të Universitetit të Tiranës.

2. Kohëzgjatja e kryerjes së këtij programi studimi të jetë 4 vite dhe ngarkesa mësimore e përgjithshme, të jetë të paktën 240 kredite. Sistemi i studimeve të jetë me kohë të plotë.

3. Në përfundim të kryerjes së këtij programi, të lëshohet diploma “Mjek specialist për mjekësi interne”.

4. Kuota e pranimit në këtë program për vitin akademik 2007-2008, të jetë 8 (tetë), për sistemin e Ministrisë së Shëndetësisë.

5. Vlera e tarifës vjetore të shkollimit përcaktohet sipas vendimit nr.161, datë 3.2.2008 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kuotave të pranimit dhe të tarifës së shkollimit për studimet specializuese afatgjata, pranë Fakultetit të Mjekësisë, të Universitetit të Tiranës, për vitin akademik 2007-2008”.

6. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Universiteti i Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1085, datë 23.7.2008

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE,
SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË KOMUNËS
SELITË TË QARKUT TË LEZHËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Selitë, të qarkut të Lezhës, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit territorial dhe administrativ

të komunës Selitë të qarkut të Lezhës, miratuar me vendimin nr.473, datë 18.7.2007, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Selitë të qarkut të Lezhës”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Selitë për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Selitë

Lidhja nr.1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1-5	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
7-9	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik	Në pronësi
11-20	Varrezat publike	Në pronësi
653-657	Infrastrukturë (sheshe, rrugë vendore, lulishte dhe shërbime publike)	Në pronësi
23-26, 28-38	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive)	Në përdorim
27	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (kanale të treta dhe toka joproduktive)	Në pronësi
663, 664	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e kanalizimeve	Në pronësi

VENDIM
Nr.1086, datë 23.7.2008

PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË BASHKISË CËRRIK TË QARKUT TË ELBASANIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të bashkisë Cërrik të qarkut të Elbasanit, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj bashkie, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të bashkisë Cërrik, të qarkut të Elbasanit, miratuar me vendimin nr.179, datë 31.3.2005 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në bashkinë Cërrik, të qarkut të Elbasanit”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe bashkia Cërrik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Bashkia Cërrik

Lidhja nr.1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1176-1200	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
1205-1208	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik	Në pronësi
1167-1173	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive	Në pronësi
1072, 1073	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e shërbimit social	Në pronësi
1-170,172,179-181,184,186,187,188,190,191,194,195-197,200,203-209,211,212,214,216,218-227,229-241,243,244,246,248,251-307,309-538,542,543,546,548,551,552,555-574,576,580-698,700-735,738,743,744,746-786,787-1044	Troje të lira dhe hapësira publike të pa zëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji	Në përdorim
1071,1074	Varreza publike	Në pronësi
1070,1406-1667	Infrastrukturë (sheshe, rrugë vendore, lulishte dhe shërbime publike)	Në pronësi
1068,1069,1161,1163-1165 1224,1225	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik	Në pronësi
1404-1720	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive)	Në përdorim
1067-1692,1721-1730,1801-1962 (vetëm kanalet e treta)	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka inproduktive dhe kanale të treta)	Në pronësi
171,173-178,182,183,185,189,192,193,198,199,201,202,210,213,215,217,228,242,245,247,249,250,308,540,541,544,545,547,549,550,575,577-579,699,736,737,739-742,745	Objekte të ish-ndërmarrjeve bujqësore	Në pronësi
1067	Prona që përdoren në fushën administrative	Në pronësi
1050-1065,1075-1160	Prona që përdoren në fushën e strehimit dhe të mbrojtjes civile	Në pronësi
1668-1676	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e kanalizimeve	Në pronësi

VENDIM
Nr.1088, datë 23.7.2008

PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË KOMUNËS GUR I ZI TË QARKUT TË SHKODRËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Gur i Zi të qarkut të Shkodrës, që transferohen në pronësi ose në përdorim të kësaj komune, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Lista me 67 (gjashtëdhjetë e shtatë) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 383 (treqind e tetëdhjetë e tre).

2. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Gur i Zi për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Gur i Zi

Lidhja nr.1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1-9	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
10-11	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik	Në pronësi
12-14	Prona që përdoren në fushën kulturore dhe sportive	Në pronësi
15-25	Varrezat publike	Në pronësi
26-35	Infrastrukturë (troje të lira)	Në përdorim
192-221;256-265	Infrastrukturë (rrugë vendore) dhe shërbim publik	Në pronësi
232-254	Prona që përdoren në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit	Në përdorim
255;270;276;284;288;293;300;309;311;315;319;321;324	Toka bujqësore inproduktive, kanale të treta	Në pronësi

VENDIM
Nr.1090, datë 2.7.2008

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.561, DATË 16.8.2006 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR PAGAT SIPAS GRADAVE PËR PUNONJËSIT, OFICERË DHE NËNOFICERË, TË GARDËS SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 “Për Buxhetin të Shtetit të vitit 2008”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lidhja nr.1 “Niveli i pagës për gradë, sipas roleve, për punonjësit e Gardës së Republikës”, e përmendur në pikën 1 të vendimit nr.561, datë 16.8.2006 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet buxhetore të planifikuara për rritjen e pagave për vitin 2008.

3. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 korrik 2008.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

LIDHJA NR.1

NIVELI I PAGËS PËR GRADË, SIPAS ROLEVE, PËR PUNONJËSIT E GARDËS SË REPUBLIKËS

Roli i punonjësve sipas gradave		Grada	Paga bazë për gradë
Për punonjësit oficerë	Madhor	Gjeneral garde	106 080
	I lartë	Kolonel	92 250
		Nënkolonel	81 230
		Major	67 080
	I mesëm	Kapiten	54 800
		Nënkapiten	51 750
	I ulët	Toger	48 840
		Nëntoger	46 860
Për punonjësit nënoficerë	Madhor	Kryekapter	37 400
	I lartë	Kapter	36 600
		Kapter shtabi	36 100
		Kapter mjeshtër	35 530
	I mesëm	Kapter i parë	34 900
		Kapter i dytë	34 430
		Kapter i tretë	34 070
	I ulët	Kapter i katërt	33 450
		Rreshter	32 870

VENDIM

Nr.1091, datë 2.7.2008

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.455, DATË 18.7.2007 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR PAGAT DHE SHITESAT MBI PAGË TË PUNONJËSVE TË SHËRBIMIT PYJOR”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 4 të nenit 7 të ligjit nr.9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar, të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 “Për Buxhetin të Shtetit të vitit 2008”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lidhja nr.1 “Struktura dhe nivelet e pagave për punonjësit e Shërbimit Pyjor”, e përmendur në pikën 1 të vendimit nr.455, datë 18.7.2007 të Këshillit të Ministrave, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet

buxhetore të planifikuara për rritjen e pagave për vitin 2008.

3. Ngarkohen Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 korrik 2008.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

LIDHJA NR.1

PAGA BAZË SIPAS KLASAVE PËR PUNONJËSIT E SHËRBIMIT PYJOR

Nr.rend.	Klasa	Paga bazë mujore në lekë
1.	I	17 000
2.	II	17 200
3.	III	17 400
4.	IV	17 600
5.	V	18 000
6.	VI	18 500
7.	VII	19 500
8.	VIII	20 500
9.	IX	21 300
10.	X	22 400
11.	XI	23 000
12.	XII	23 400
13.	XIII	24 000
14.	XIV	24 800
15.	XV	26 500
16.	XVI	27 500
17.	XVII	29 000
18.	XVIII	30 300
19.	XIX	31 000
20.	XX	31 500
21.	XXI	32 400
22.	XXII	35 500
23.	XXIII	36 800

VENDIM
Nr.1092, datë 2.7.2008

PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELEVE TË PAGAVE TË PUNONJËSVE TË DOGANAVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave dhe të Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Struktura dhe nivelet e pagave të punonjësve të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave të jenë sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Paga e grupit (kolona 2), e lidhjes nr.1 “Diplomë e shkollës së lartë”, është 11 000 (njëmbëdhjetë mijë) lekë.

3. Shtesa për vjetërsi në punë (kolona 3), e lidhjeve nr.1, të jepet në masën 2 për qind, pas çdo viti pune, deri në 25 vjet, dhe llogaritet mbi pagën e grupit, për punonjësit me arsim të lartë.

Për punonjësit mbështetës vjetërsia në punë llogaritet në masën 1 për qind mbi pagën e

pozicionit, pas çdo viti pune, deri në 25 vjet.

4. Shtesa për kualifikim (kolona 4), e lidhjes nr.1, përcaktohet, si më poshtë vijon:

Nëpunësit e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave përfitojnë shtesë, për kualifikim, gradë apo titull shkencor, të përcaktuar sipas lidhjes nr.2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Kriteret e përfitimit të shtesës janë:

a) Kjo shtesë jepet kur kualifikimi, grada apo titulli shkencor përputhen me përshkrimin e punës së nëpunësit, pas miratimit, rast pas rasti, nga Departamenti i Administratës Publike.

b) Kur nëpunësi ka kualifikim, gradë apo titull më të lartë, se ai i përcaktuar për pozicionin e tij, sipas lidhjes nr.2, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfiton vetëm shtesën e përcaktuar për pozicionin.

c) Kur nëpunësi ka kualifikim, gradë apo titull më të ulët, se ai i përcaktuar për pozicionin e tij, sipas lidhjes nr.2, që i bashkëlidhet këtij vendimi, e përfiton shtesën në përputhje me kualifikimin, gradën apo titullin shkencor.

Në çdo rast, si më sipër pavarësisht nga kualifikimi, grada apo titulli, që ka nëpunësi, ai përfiton shtesën vetëm për gradën apo titullin shkencor më të lartë.

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, për aplikimin e shtesës për kualifikim, duhet të zbatojë rregullat e udhëzimit nr.1, datë 18.4.2008 të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, Ministrisë së Financave dhe Departamentit të Administratës Publike.

5. Shtesa për pozicion është sipas kolonës 5, të lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

6. Shtesa për kushte pune është përcaktuar për çdo emërtesë, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

7. Nëpunësit, që përfshihen në fushën e veprimit të këtij vendimi, nuk përfitojnë shtesa të tjera mbi pagë, me përjashtim të emërtesës “Sanitar”, e cila përfiton shtesën për dëmshmëri shëndeti, sipas përcaktimeve të vendimit nr.726, datë 21.12.2000 të Këshillit të Ministrave “Për pagat e punonjësve të institucioneve buxhetore”, të ndryshuar.

8. Vendimet nr.437, datë 3.9.1993 “Për pagat e punonjësve të tatimeve dhe të doganave”, dhe nr.358, datë 28.7.1999 “Për miratimin e strukturës së pagave të punonjësve të doganave”, të ndryshuar, të Këshillit të Ministrave, shfuqizohen.

9. Ngarkohet Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 korrik 2008.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

LIDHJA NR.1

STRUKTURA E PAGAVE TË SISTEMIT DOGANOR

STRUKTURA DHE NIVELET E PAGAVE TË NËPUNËSVE NË APARATIN E DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË DOGANAVE

Klasifikimi doganor	Pozicioni	Kategoria	Paga e grupit (PG)	Shtesa vjetore për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK)	Shtesa e pozicionit (SHP)	Shtesa për kushte pune
1		1	2	3	4	5	6
	Titullari i institucionit	II-a	11000	2%		103 500	20 000
A	Zëvendës drejtor i Përgjithshëm	II-b	11000	2%		86 500	15 000
	Këshilltar, Drejtor drejtorie, Drejtor drejtorie rajonale, Kryetar i degës doganore Tiranë, Durrës, Vlorë,	III-a	11000	2%		68 500	15 000

	Shkodër, Gjirokastrë						
B	Përgjegjës sektori, Kryetar dege doganore Fier, Kapshticë, Korçë, Lezhë, Bllatë, Kukës, Sarandë, Berat, Tri Urat, Qafë-Thanë, Elbasan, Përgjegjës operacionesh doganore në degën doganore Tiranë, Durrës	III-a/1	11000	2%		58 300	14 000
C.1	Inspektor kontrolli i brendshëm, Përgjegjës turni, Përgjegjës zyre doganore, Komandant grupi antikontrabandë, Specialist laborator, Specialist, Administrator rrjeti, Jurist	III-b	11000	2%		51 500	14 000
	Financier në degë doganore, Përkthyes, Koordinator në DOH, Specialist i marrëdhënieve ndërkombëtare	III-b	11000	2%		51 500	12 000
C.2	Doganier kontrolli, dokumentar, fizik, Inspektor antikontrabande, Asistent laborator, Llogaritar	IV-a	11000	2%		39 000	12 000
C.3	Doganier pranues, Doganier peshoreje, Doganier pike kontrolli, Përpunues informacioni, Sekretar, Arkivist			1%		31 000	11 000
D.1	Magaziner, Furnitor, Operator, Shofer, Teknik			1%		27 400	6 000
D.2	Punëtor mirëmbajtje			1%		18 500	5 000
D.3	Sanitar			1%		17 000	2 000

LIDHJA NR.2

POZICIONI	KUALIFIKIMI/GRADA/TITULLI SHKENCOR	SHTESA (LEKË/MUAJ)
Titullar i institucionit	Profesor	30 000
	Profesor i asocuar	25 000

Zëvendëstitullar i institucionit Drejtor drejtorie	Doktor i shkencave	20 000
	Doktor i shkencave	25 000
Përgjegjës/shef sektori, turni, kryetar dege doganore Specialist, doganier, koordinator, këshilltar	Studime të thelluara pasuniversitare/master i nivelit të dytë Studime specializuese afatgjatë	10 000
	Studime të thelluara pasuniversitare/master i nivelit të dytë	20 000

Shënim. Vlerat 20 000 lekë për diplomat “Master i nivelit të dytë/studime të thelluara pasuniversitare” dhe 25 000 lekë, për gradën shkencore “Doktor i shkencave”, aplikohen për nëpunësit/titullarët, që i kanë përfituar diplomat përkatëse në universitetet, apo shkollat e larta të vendeve të përcaktuar sipas listës që i bashkëlidhet udhëzimit të përbashkët të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, Ministrisë së Financave dhe Departamentit të Administratës Publike.

VENDIM
Nr.1093, datë 2.7.2008

PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELEVE TË PAGAVE TË PUNONJËSVE TË SISTEMIT TATIMOR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave dhe të Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Struktura dhe nivelet e pagave të punonjësve të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve të jenë sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Paga e grupit (kolona 2), e lidhjes nr.1 “Diploma e shkollës së lartë”, është 11 000 (njëmbëdhjetë mijë) lekë.

3. Shtesa për vjetërsi në punë (kolona 3), e lidhjeve nr.1, jepet në masën 2 për qind, pas çdo viti pune, deri në 25 vjet, dhe llogaritet mbi pagën e grupit.

4. Shtesa për kualifikim (kolona 4), e lidhjes nr.1, përcaktohet si më poshtë vijon:

Nëpunësit e Drejtorisë së Përgjithshme të tatimeve përfitojnë shtesë për kualifikim, gradë apo titull shkencor, të përcaktuar sipas lidhjes nr.2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Kriteret e përfitimit të shtesës janë:

a) Kjo shtesë jepet kur kualifikimi, grada apo titulli shkencor përputhen me përshkrimin e punës së nëpunësit, pas miratimit, rast pas rasti, nga Departamenti i Administratës Publike.

b) Kur nëpunësi ka kualifikim, gradë apo titull më të lartë, se ai i përcaktuar për pozicionin e tij, sipas lidhjes nr.2, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfiton vetëm shtesën e përcaktuar për pozicionin.

c) Kur nëpunësi ka kualifikim, gradë apo titull më të ulët, se ai i përcaktuar për pozicionin e tij, sipas lidhjes nr.2, që i bashkëlidhet këtij vendimi, e përfiton shtesën në përputhje me kualifikimin, gradën apo titullin shkencor.

Në çdo rast si më sipër, pavarësisht nga kualifikimi, grada apo titulli, që ka nëpunësi, ai përfiton shtesën vetëm për gradën apo titullin shkencor më të lartë.

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve për aplikimin e shtesës për kualifikim duhet të zbatojë rregullat e udhëzimit nr.1, datë 18.4.2008 të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, Ministrisë së Financave dhe Departamentit të Administratës Publike.

5. Shtesa për pozicion është sipas kolonës 5, të lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
6. Nëpunësit, që përfshihen në fushën e veprimit të këtij vendimi, nuk përfitojnë shtesa të tjera mbi pagë.
7. Pagat për pozicionet mbështetëse në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve të jenë sipas lidhjes II/M dhe II-5, të vendimit nr.726, datë 21.12.2000 të Këshillit të Ministrave “Për pagat e punonjësve të institucioneve buxhetore, të ndryshuar.
8. Vendimet nr.437, datë 3.9.1993 “Për pagat e punonjësve të tatimeve dhe të doganave”, dhe nr.369, datë 14.6.2006 “Për miratimin e strukturës dhe të nivelit të pagave të punonjësve të sistemit tatimor”, të ndryshuar, të Këshillit të Ministrave, shfuqizohen.
9. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet e parashikuara për politikën e pagave, miratuar për vitin 2008.
10. Ngarkohet Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 korrik 2008.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

LIDHJA NR.1

STRUKTURA E PAGAVE TË SISTEMIT TATIMOR
STRUKTURA DHE NIVELET E PAGAVE TË NËPUNËSVE NË APARATIN E DREJTORISË SË
PËRGJITHSHME TË TATIMEVE

POZICIONI	Kategoria	Paga e grupit (PG)	Shtesa vjetore për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK)	Shtesa e pozicionit (SHP)	Shtesa për kushte pune
	1	2	3	4	5	6
Titullari i institucionit	II-a	11000	2%		103 500	20 000
Zëvendësdrejtor i Përgjithshëm	II-b	11000	2%		86 500	15 000
Drejtor drejtorie	III-a	11000	2%		68 500	15 000
Përgjegjës sektori	III-a/1	11000	2%		58 300	14 000
Përgjegjës sektori	III-b	11000	2%		51 500	10 000
Inspektor auditit i brendshëm/kontroll i brendshëm	III-b	11000	2%		51 500	10 000
Specialist	IV-a	11000	2%		39 000	10 000
Specialist	IV-b	11000	2%		29 000	10 000
Sekretar	IV-b	11000	2%		29 000	5 000

STRUKTURA DHE NIVELET E PAGAVE TË NËPUNËSVE NË DREJTORITË RAJONALE TË
TATIMEVE

POZICIONI	Kategoria	Paga e grupit (PG)	Shtesa vjetore për vjetërsi	Shtesa për kualifikim (SHK)	Shtesa e pozicionit (SHP)	Shtesa për kushte pune
-----------	-----------	--------------------	-----------------------------	-----------------------------	---------------------------	------------------------

			(SHV)			
	1	2	3	4	5	6
Drejtoria rajonale	III-a	11000	2%		68 500	15 000
Drejtor Drejtorie	III-a/1	11000	2%		58 300	15 000
Përgjegjës sektori/zyre	III-b	11000	2%		51 500	13 000
Specialist/inspektor I	IV-a	11000	2%		39 000	13 000
Specialist/inspektor II	IV-b	11000	2%		29 000	11 000
Specialist/sekretar	IV-c	11000	2%		21 500	5 000

LIDHJA NR.2

POZICIONI	KUALIFIKIMI/GRADA/TITULLI SHKENCOR	SHTESA (LEKË/MUAJI)
Titullar i institucionit	Profesor	30 000
	Profesor i asocuar	25 000
Zëvendësitar i institucionit Drejtor drejtorie	Doktor i shkencave	20 000
	Doktor i shkencave	25 000
Përgjegjës/shfektori inspektor, specialist	Studime të thelluara pasuniversitare/master i nivelit të dytë Studime specializuese afatgjatë	10 000
	Studime të thelluara pasuniversitare/master i nivelit të dytë	20 000

Shënim. Vlerat 20 000 lekë për diplomën “Master i nivelit të dytë/studime të thelluara pasuniversitare” dhe 25 000 lekë, për gradën shkencore “Doktor i shkencave”, aplikohen për nëpunësit/titullarët, që i kanë përfituar diplomën përkatëse në universitetet, apo shkollat e larta të vendeve të përcaktuara sipas listës që i bashkëlidhet udhëzimit të përbashkët të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, Ministrisë së Financave dhe Departamentit të Administratës Publike.

VENDIM

Nr.1095, datë 2.7.2008

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.194, DATË 22.4.1999 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS SË PAGËS SË PUNONJËSVE MËSIMORË, NË ARSIMIN PARAUNIVERSITAR”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.194, datë 22.4.1999 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Lidhja nr.1 “Struktura e pagës për punonjësit mësimorë”, e përmendur në pikën 1, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

b) Lidhja nr.2 “Paga e grupit”, e përmendur në pikën 2, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

c) Në paragrafin e dytë të pikës 2, fjala “në profil” shfuqizohet.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet buxhetore të planifikuara për rritjen e pagave, për vitin 2008.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ministria e Arsimit dhe Shkencës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 korrik 2008.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

LIDHJA NR.1

STRUKTURA E PAGËS PËR PUNONJËSIT MËSIMORË TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

EMËRTIMI		PAGA MUJORE			
		PAGA INDIVIDUALE			SHTESA E POZICIONIT
		Paga e grupit (PG)	Shtesa për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikimin (SHK)	
		1	2	3	4
1	Drejtor i shkollës së mesme, Përgjegjës poligoni, Drejtor i institutit të nxënësve që nuk shikojnë, Drejtor i institutit të nxënësve që nuk dëgjojnë, Drejtor në shkollat me probleme të larta mendore, Drejtor i konvikteve	1	2% e P.G.	5% e P.G. 10% e P.G. 20% e P.G.	40 000
2	Zëvendësdrejtor i shkollës së mesme, Përgjegjës i bazës prodhuese, Zëvendësdrejtor i institutit të nxënësve që nuk shikojnë, Zëvendësdrejtor i institutit të nxënësve që nuk dëgjojnë, Zëvendësdrejtor në shkollat me probleme të larta mendore, Drejtor i Qendrës Kulturore të Fëmijëve.	1	2% e P.G.	5% e P.G. 10% e P.G. 20% e P.G.	35 000
3	Drejtor i shkollës 9-vjeçare	1	2% e P.G.	5% e P.G. 10% e P.G. 20% e P.G.	31 500
4	Drejtor i shkollës fillore klasa I-IV-ërt, Përgjegjës (kryemësues) i shkollës me klasë kolektive, Zëvendësdrejtor i shkollës 9-vjeçare, Përgjegjës sektori në Qendrën Kulturore të Fëmijëve	1	2% e P.G.	5% e P.G. 10% e P.G. 20% e P.G.	29 500
5	Drejtor i kopshtit me ushqim	1	2% e P.G.	5% e P.G. 10% e P.G. 20% e P.G.	28 500
6	Drejtor i kopshtit pa ushqim	1	2% e P.G.	5% e P.G. 10% e P.G. 20% e P.G.	26 500
7	Mësues në shkollat e mesme, Mësues në institutin e nxënësve që nuk shikojnë, Mësues në institutin e nxënësve që nuk dëgjojnë, Mësues në shkollat me probleme të larta mendore, Inspektor në Qendrën	1	2% e P.G.	5% e P.G. 10% e P.G. 20% e P.G.	28 500

	Kulturore të Fëmijëve				
8	Mësues në shkollat 9-vjeçare, klasa I-IX. Edukator konvikti, Kujdestar konvikti	1	2% e P.G.	5% e P.G. 10% e P.G. 20% e P.G.	25 600
9	Edukator në kopësht fëmijësh	1	2% e P.G.	5% e P.G. 10% e P.G. 20% e P.G.	23 000
10	Mësues	2	2% e P.G.	5% e P.G. 10% e P.G. 20% e P.G.	21 000
11	Mësues	3	2% e P.G.	5% e P.G. 10% e P.G. 20% e P.G.	21 000
12	Edukator në kopësht fëmijësh	3	2% e P.G.	5% e P.G. 10% e P.G. 20% e P.G.	19 300
13	Edukator në kopësht fëmijësh	2	2% e P.G.	5% e P.G. 10% e P.G. 20% e P.G.	19300

LIDHJA NR.2

VLERA E PAGËS SË GRUPIT SIPAS NIVELIT ARSIMOR

GRUPI	PAGA NË LEKË
1	11 000
2	9 000
3	7 500
4	4 700

VENDIM

Nr.1096, datë 2.7.2008

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR.438, DATË 13.7.2007 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR PAGAT E PUNONJËSVE TË POLICISË SË MBROJTJES NGA ZJARRI DHE SHPËTIMIT”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 35 të ligjit nr.8766, datë 5.4.2001 “Për mbrojtjen nga zjarri dhe për shpëtimin”, të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.438, datë 13.7.2007 të Këshillit të Ministrave, të bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

a) Lidhja nr.1 “Struktura dhe nivelet e pagave për punonjësit e Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit”, e përmendur në pikën 1, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

b) Pas pikës 3 shtohet pika 4, me këtë përmbajtje:

“4. Specialistët, përgjegjësit e sektorit apo drejtorët në Policinë e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit, që punojnë në pozicione, që lidhen me procesin e informatizimit të veprimtarisë së kësaj policie, për të cilat është i detyrueshëm arsimi i lartë, në degët “Inxhinieri elektronike” apo

“Informatikë”, përfitojnë një shtesë, për kushte pune, 10 000 (dhjetë mijë) lekë mbi pagën mujore të gradës përkatëse. Zbatimi i kësaj shtese bëhet pas miratimit paraprak të Departamentit të Administratës Publike dhe Ministrisë së Financave, sipas parashikimit të pozicioneve të punës.”.

c) Pikat 4, 5 e 6 numërtohen, përkatësisht, 5, 6 e 7.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet buxhetore të planifikuara për rritjen e pagave, për vitin 2008.

3. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 korrik 2008.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

LIDHJA NR.1

**STRUKTURA DHE NIVELET E PAGAVE PËR PUNONJËSIT E POLICISË SË
MBROJTJES NGA ZJARRI DHE SHPËTIMIT**

Roli	Grada	Paga bazë për gradë	Shtesa për natyrë të veçantë pune e shërbimi
1	2	3	4
Bazë	Agjent	33 000	7000
	Agjent i I-rë	34 500	7000
	Asistent	36 000	8000
	Asistent i I-rë	38 000	8000
	Kryeasistent	40 000	8000
I mesëm	Nëninspektor	46 000	6000
	Inspektor	49 000	6000
	Kryeinspektor	56 000	6000
I lartë	Nënkomisar	66 500	6000
	Komisar	82 000	6000
	Kryekomisar	94 000	6000
Madhor	Drejtues	105 000	
	Drejtues i I-rë	115 000	

VENDIM
Nr.1097, datë 2.7.2008

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.366, DATË 14.6.2006 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR PAGAT E PUNONJËSVE TË POLICISË SË BURGJEVE”, TË
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lidhja nr.1 “Struktura dhe nivelet e pagave për punonjësit e Policisë së Burgjeve”, e përmendur në pikën 1 të vendimit nr.366, datë 14.6.2006 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet buxhetore të planifikuara për rritjen e pagave, për vitin 2008.

3. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 korrik 2008.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

LIDHJA NR.1

STRUKTURA DHE NIVELET E PAGAVE PËR PUNONJËSIT E POLICISË SË
BURGJEVE

Roli	Grada	Paga bazë për gradë	Shtesa për natyrë të veçantë pune e shërbimi	
			Në funksion të policisë së regjimeve të jashtme	Në funksion të policisë së regjimeve të brendshme dhe transferim shoqërimet
1	2	3	4	5
Bazë	Agjent	33 000	4000	7000
	Agjent i I-rë	34 500	4000	7000
	Asistent	36 500	4000	8000
	Asistent i I-rë	37 500	4000	8000
	Kryeasistent	39 000	4000	8000
I mesëm	Nëninspektor	46 500	4000	6000
	Inspektor	48 500	4000	6000
	Kryeinspektor	55 500	4000	6000
I lartë	Nënkomisar	68 000	4000	6000
	Komisar	82 000	4000	6000
	Kryekomisar	94 000	4000	6000
Madhor	Drejtues	105 000	8000	
	Drejtues i I-rë	115 000	8000	

VENDIM

Nr.1100, datë 30.7.2008

PËR MIRATIMIN E PLANIT AFATMESEM TË VEPRIMIT TË PROGRAMIT “BRAIN GAIN”, PËR PERIU DHËN 2008-2009

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 21 e 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 11 të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e planit të veprimit të programit “Brain Gain”, për periudhën 2008-2009.
2. Kryeministritë, në buxhetin e miratuar për vitin 2008, t’i shtohet fondi 24 400 000 (njëzet e katër milionë e katërqind mijë) lekë, për mbulimin e pjesshëm të efekteve financiare, të vitit 2008, për planin afatmesëm të veprimit të programit “Brain Gain”, i cili do të bashkëfinancohet nga Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara (UNDP).
3. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.
Ngarkohet Kryeministria për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1106, datë 30.7.2008

**PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS SË PAGËS SË PUNONJËSVE TË AGJENCISË SË
ADMINISTRIMIT TË PASURIVE TË SEKUESTRUARA DHE TË KONFISKUARA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave dhe të Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Struktura dhe nivelet e pagave të punonjësve të Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara paraqiten, si më poshtë vijon:

a) Paga mujore për pozicionin “Titullar i institucionit (Kryeadministrator)” njësohet me pagën e pozicionit “Drejtor drejtorie në ministri”, kategoria II-b, sipas vendimit nr.475, datë 13.7.2007 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar.

b) Paga mujore për pozicionin “Administrator” njësohet me pagën e pozicionit “Përgjegjës sektori, i nivelit të lartë”, klasa III, kategoria III-a, sipas vendimit nr.475, datë 13.7.2007 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar.

c) Paga mujore për pozicionin “Jurist” njësohet me pagën e pozicionit “Përgjegjës sektori i nivelit të ulët”, klasa III, kategoria III-a/1, sipas vendimit nr.475, datë 13.7.2007, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar.

d) Paga mujore për pozicionin “Specialist” njësohet me pagën e pozicionit “Specialist i nivelit të mesëm”, klasa IV, kategoria IV-a, sipas vendimit nr.475, datë 13.7.2007 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, fillojnë nga data e emërimit të punonjësve, pas miratimit të strukturës, dhe do të përballohen nga buxheti i vitit 2008, miratuar për Agjencinë e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara.

3. Ngarkohet Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1108, datë 30.7.2008

**PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
SHTETËRORE, TË CILAT KALOJNË NË PRONËSI TË OPERATORIT TË SISTEMIT TË
SHPËRNDARJES, SHA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 8,13 e 15 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore të sistemit të shpërndarjes së energjisë elektrike, të cilat kalojnë në pronësi të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) sh.a., sipas lidhjeve (gjithsej 1416 fletë), që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Heqjen nga inventari i pronave të paluajtshme shtetërore, të sistemit të prodhimit, transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike, në përgjegjësi administrimi të KESH sh.a.-së, miratuar me vendimin nr.122, datë 4.3.2004 të Këshillit të Ministrave, të pronave, që i përkasin sistemit të shpërndarjes, sipas fletëve, të përcaktuara në shtojcën nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Në inventarin e pronave të paluajtshme shtetërore të sistemit të prodhimit dhe të transmetimit të energjisë elektrike, në përgjegjësi administrimi të KESH sh.a.-së, ndryshohen të dhënat për pronat, sipas tabelave (gjithsej 3 fletë), që i bashkëlidhen këtij vendimi.

4. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe Ministria e Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

SHTOJCA NR.1

- 118-154;
- 157;
- 158 (pronat nr.5 e nr.6);
- 159;
- 160 (prona nr.2);
- 161-166;
- 168-179;
- 180 (pronat nr.2 e nr.3);
- 181-182;
- 183 (pronat nr.2, nr.3 e nr.4);
- 184-259;
- 261-284;
- 285;
- 286 (pronat nr.1/6, nr.1/7, nr.1/8, nr.1/9, nr.1/10, nr.1/11, nr.1/15 e nr.1/16);
- 287-449;
- 450 (pronat nr.1.21, nr.1.22, nr.1.23, nr.1.24, nr.2.1, e nr.2.2);
- 451-618;
- 625-690;
- 692-735;
- 737-1 352.

3.FORMULAR PËR INVENTARIZIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE
(Të tipit të pronave që inventarizohen si klasa të veçanta)

Institucioni i pushtetit qendror: METE, KESH sh.a.
Bashkia: Tiranë
Fusha e përdorimit të pronës: KESH sh.a.

Identifikoi: Erion Bozgo Shef Sektori
(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)
Supervizoi: Çlirim Çomo Drejtor i DPP
(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)
Aprovoi: Gjergj Bojaxhi, Drejtor i Përgjithshëm
(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar, tel,firma,vula)

A			B				C			
Nr.	Zona kadastr&Indeksi i hartës	Nr.i pasurisë	Emërtesa e pronës, vendndodhja, shtrirja gjeografike	Komponentët përbërës të pronës	Adresa, vendndodhja e komponentëve përbërës	Përmasat e pronës në m ² ose ml	Funksioni për të cilin përdoret prona	Institucioni,enti me përgjegjësi administrative	Institucioni,enti përdorues, statusi juridik i përdorimit	Të dhëna të tjera (Shënime të veçanta)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
								METE KESH sh.a.	KESH sh.a.	
1				Godina e Institutit të Energjetikës	Blloku “Vasil Shanto”	320 m ²	Zyra e administratës qendrore të KESH	“	“	Sip.ndërtimi 320 m ² një katëshe

3.FORMULAR PËR INVENTARIZIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE
(të tipit të pronave që inventarizohen si klasa të veçanta)

Institucioni i pushtetit qendror: METE, KESH sh.a.
 Komuna: Qendër-Fier
 Fusha e përdorimit të pronës: KESH sh.a.

Identifikoi: Erion Bozgo Shef Sektori
 (emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)
 Supervizoi: Çlirim Çomo Drejtor i DPP
 (emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)
 Aprovoi: Gjergj Bojaxhi, Drejtor i Përgjithshëm
 (emri, mbiemri, pozicioni zyrtar, tel, firma,vula)

A			B				C			
Nr.	Zona kadastr&Indeksi i hartës	Nr.i pasurisë	Emërtesa e pronës, vendndodhja, shtrirja gjeografike	Komponentët përbërës të pronës	Adresa, vendndodhja e komponentëve përbërës	Përmasat e pronës në m ² ose ml	Funksioni për të cilin përdoret pronja	Institucioni, enti me përgjegjësi administrative	Institucioni,enti përdorues,statusi juridik i përdorimit	Të dhëna të tjera (Shënime të veçanta)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
								METE KESH sh.a	KESH sh.a.	
1			TEC FIER	TEC FIER	Komuna Qendër Fshati Drizë	170.950 m ²	Prodhim energjie	“	“	

3.FORMULAR PËR INVENTARIZIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHITETËRORE (të tipit të pronave që inventarizohen si klasa të veçanta)

Institucioni i pushtetit qendror: METE, KESH sh.a.

Identifikoi: Erion Bozgo Shef Sektori

Bashkia: Tiranë

Fusha e përdorimit të pronës: KESH sh.a.

(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)

Supervizoi: Çlirim Çomo Drejtor i DPP

(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)

Aprovoi: Gjergj Bojaxhi, Drejtor i Përgjithshëm

(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar, tel, firma, vula)

A		B					C			
Nr.	Zona kadastr&Indeksi i hartës	Nr.i pasurisë	Emërtesa e pronës, vendndodhja, shtrirja gjeografike	Komponentët përbërës të pronës	Adresa, vendndodhja e komponentëve përbërës	Përmasat e pronës në m ² ose ml	Funksioni për të cilin përdoret prona	Institucioni, enti me përgjegjësi administrative	Institucioni,enti përdorues, statusi juridik i përdorimit	Të dhëna të tjera (Shënime të veçanta)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
								METE KESH sh.a.	KESH sh.a.	
1				Magazinat 6, 7, 8, 9, 10	Bashkia Tiranë pranë qytetit të nxënësve Selitë	9100	Për magazina	“	“	Sip.ndërtimi 1600 m ²

VENDIM
Nr.1109, datë 30.7.2008

PËR SIGURIMIN E PUNONJËSVE, TË PUNËSUAR NË VEPRIMTARINË MINERARE,
NGA AKSIDENTET NË PUNË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 6 e 40 të ligjit nr.7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të neneve 91 e 93 të ligjit nr.7796, datë 17.2.1994 “Ligji mineral i Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Personat, që zotërojnë leje për të ushtruar veprimtari minerare brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, detyrohen të kryejnë sigurimin e punonjësve të tyre nga aksidentet personale në punë, sipas një kontrate, pranë një shoqërie sigurimi.

2. Kontrata e sigurimit të punonjësve nga aksidentet personale në punë duhet të mbulojë rastet e:

- a) humbjes së jetës;
- b) paafësisë së përhershme, të plotë ose të pjesshme;
- c) paafësisë së përkohshme, të plotë ose të pjesshme.

3. Shuma për çdo punonjës të siguruar, e përcaktuar në formularin e kontratës së sigurimit, nuk mund të jetë më e ulët se 6 000 000 (gjashtë milionë) lekë.

4. Tarifa e primit të sigurimit nuk mund të jetë më e ulët se 0.5 për qind e shumës së siguruar, të shënuar në formularin e kontratës së sigurimit.

5. Kushtet standarde të kontratës së sigurimit, përfshirë tabelën e koeficientëve të përfitimit, sipas dëmtimeve shëndetësore, miratohen nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, në mbështetje të pikës 8 të nenit 14 të ligjit nr.9572, datë 3.7.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”. Këto kushte shërbejnë si kushte minimale, të detyrueshme për t’u zbatuar nga shoqëritë e sigurimeve, për sigurimin e punonjësve, në përputhje me pikën 1 të këtij vendimi.

6. Periudha e veprimtarisë minerare, e përcaktuar sipas të drejtave minerare, të përfituara nga lejet minerare, duhet të jetë e mbuluar nga kontrata e sigurimit, e cila mund të jetë vjetore dhe e rinovueshme çdo vit ose për të gjithë kohën e veprimtarisë minerare.

7. Subjektet minerare, që do të pajisen me leje minerare sipas kërkesave të ligjit mineral të Shqipërisë, duhet të kryejnë sigurimin e punonjësve ndaj aksidenteve, përpara fillimit dhe gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre minerare.

8. Subjektet minerare, të pajisura me leje minerare e që sot zhvillojnë veprimtari minerare, brenda një periudhe 90-ditore nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, duhet të realizojnë sigurimin e punonjësve të punësuar ndaj aksidenteve.

9. Subjektet minerare duhet të paraqesin, pranë strukturave përgjegjëse, në ministrinë, që mbulon veprimtarinë minerare, dokumentet që vërtetojnë sigurimin ndaj aksidenteve. Fillimi ose vazhdimi i veprimtarisë minerare kryhet pas konfirmimit nga këto struktura se sigurimi është në përputhje me kërkesat e këtij vendimi.

10. Shoqëria nuk do ta ushtrojë veprimtarinë minerare deri në çastin e paraqitjes dhe të miratimit të këtij dokumenti në organin, që ka lëshuar lejen minerare. Mosrespektimi i një detyrimi të tillë vlerësohet shkelje e dispozitave të ligjit nr.7796, datë 17.2.1994 “Ligji mineral i Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe trajtohet, sipas kapitullit të masave ndëshkuese të këtij ligji, me vlerën e gjobës maksimale dhe heqjen e të drejtave minerare.

11. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1110, datë 30.7.2008

**PËR CILËSINË E LËNDËS DJEGËSE DIEZEL, TË PRODHUAR NGA RAFINIMI I
NAFTËS BRUTO, VENDASE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5 të nenit 10 të ligjit nr.8897, datë 16.5.2002 “Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja”, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe të Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lënda djegëse diezel, e cila në nomenklaturën e mallrave përshkruhet në kodin 27101941, e që plotëson kërkesat e standardit shqiptar S SH EN 590 ose të standardeve të tjera, të barasvlefshme me të, e prodhuar nga rafinimi i naftës bruto, të nxjerrë në vendburimet brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, do të lejohet të tregtohet sipas kushteve të përcaktuara, si më poshtë vijon:

a) Nga data 1 janar 2010, përmbajtja e squfurit në lëndën djegëse, për motorët, diezel, nuk lejohet të kalojë vlerën 350 mg/kg dhe përmbajtja e hidrokarbureve policiklike aromatike nuk lejohet të kalojë vlerën 16% m/m.

b) Nga data 1 janar 2011, përmbajtja e squfurit në lëndën djegëse, për motorët, diezel, nuk lejohet të kalojë vlerën 150 mg/kg dhe përmbajtja e hidrokarbureve policiklike aromatike nuk lejohet të kalojë vlerën 16% m/m.

c) Nga data 1 janar 2012, përmbajtja e squfurit në lëndën djegëse, për motorët, diezel, nuk lejohet të kalojë vlerën 10 mg/kg dhe duhet të plotësojë kërkesat e standardit shqiptar S SH EN 590 ose të standardeve të tjera, të barasvlefshme me të.

2. Nëse pas afateve të përcaktuara në shkronjat “a”, “b” e “c” të pikës 1 të këtij vendimi, vërehet tregtimi i lëndës djegëse diezel, me cilësi, që nuk respekton kërkesat e këtij vendimi, lënda djegëse sekuestrohet dhe dërgohet në destinacionin e përcaktuar nga Inspektorati Qendror Teknik.

3. Ngarkohet Inspektorati Qendror Teknik për kontrollin e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1111, datë 30.7.2008

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE,
SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË KOMUNËS
LIBONIK TË QARKUT TË KORÇËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Libonik të qarkut të Korçës, sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Libonik të qarkut të Korçës, miratuar me vendimin nr.400, datë 9.6.2005 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Libonik të qarkut të Korçës.”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Libonik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Libonik

Lidhja nr.1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1-12	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
20-26 (vetëm objekti)	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik	Në pronësi
13-19	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive	Në pronësi
27-40	Prona që përdoren në fushën e strehimit dhe të mbrojtjes civile	Në pronësi
41-57	Varrezat publike	Në pronësi
259-418 (vetëm trojet)	Troje të lira dhe hapësira publike të pa zëna ndërmjet ndërtesave ose objektevetë çdo lloji	Në përdorim
73-255, 259-418 (vetëm sheshet)	Infrastrukturë (sheshe, rrugë vendore, lulishte dhe shërbime publike)	Në pronësi
495-522	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik	Në pronësi
467, 468, 471-474, 476-479, 481, 482, 485, 487, 488, 491, 492,	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive)	Në përdorim
469, 470, 475, 480, 483, 484, 486, 489, 490, 493, 494, 527, 537, 584, 553, 560, 571, 573,	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (kanale të treta dhe toka joproduktive)	Në pronësi
58-72	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e ujësjellës-kanalizimeve	Në pronësi

VENDIM

PËR DISA ÇËSHTJE NË ZBATIM TË LIGJEVE NR.7703, DATË 11. 5.1993 “PËR SIGURIMET SHOQËRORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR, NR.9136, DATË 11.9.2003 “PËR MBLEDHJEN E KONTRIBUTEVE TË DETYRUESHME TË SIGURIMEVE SHOQËRORE DHE SHËNDETËSORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR, DHE NR.7870, DATË 13.10.1994 “PËR SIGURIMET SHËNDETËSORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.7870, datë 13.10.1994 “Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. MBROJTJA DHE SIGURIMI I DETYRUESHËM

1. Në mbështetje të neneve 2, 7 e 9 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të neneve 7 e 8 të ligjit nr.7870, datë 13.10.1994 “Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, quhen persona të mbrojtur:

a) të punësuarit me mandat kushtetues, të punësuarit e emëruar, të punësuarit me kontratë pune, pa afat ose me afat më shumë se një muaj, që punojnë me kohë të plotë ose të pjesshme, për më shumë se 87 orë në muaj, të cilët sigurohen në mënyrë të detyrueshme për sëmundje, barrë lindje, pensione, aksidente në punë e sëmundje profesionale, papunësinë dhe sigurimin shëndetësor;

b) të punësuarit me kontratë pune, me ose pa afat, por me kohë të pjesshme, që zgjat më pak se 87 orë në muaj, të cilët sigurohen në mënyrë të detyrueshme, por jo më pak se niveli minimal, për barrë lindje, pensione, aksidente në punë e sëmundje profesionale dhe në sigurimin shëndetësor;

c) të punësuarit me kontratë pune, me afat më pak se një javë gjatë vitit, me kohë të plotë ose të pjesshme ditore, të cilët sigurohen në mënyrë të detyrueshme, në nivelin minimal, për aksidente në punë, sëmundje profesionale dhe sigurim shëndetësor;

ç) pronarët e personave juridikë, që ushtrojnë funksione drejtuese në shoqëri, si administratorë apo çdo funksion tjetër, të cilët, si të punësuar pranë shoqërisë, sigurohen në mënyrë të detyrueshme për sëmundje, barrë lindje, pensione, aksidente në punë e sëmundje profesionale, papunësinë dhe sigurim shëndetësor;

d) personat fizikë, të vetëpunësuar, që ushtrojnë veprimtari ekonomike, pavarësisht nga kohëzgjatja e saj, të cilët sigurohen në mënyrë të detyrueshme për barrë lindje, pensione dhe sigurim shëndetësor;

dh) të vetëpunësuarit në bujqësi, të aftë për punë, që kanë mbushur moshën 16 vjeç, deri në moshën për pension, sipas nenit 92 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, kur:

i) nuk janë të siguruar nga punësimi në sektorë të tjerë, banojnë në të njëjtin nënqark, ku kanë tokën, në pronësi ose në përdorim, dhe zhvillojnë veprimtari bujqësore e blegtorale, të cilët sigurohen në mënyrë të detyrueshme, për barrë lindje, për pensione dhe për sigurim shëndetësor.

ii) nuk janë të siguruar nga punësimi në sektorë të tjerë, banojnë në fshat dhe zhvillojnë veprimtari, bujqësore e blegtorale, edhe nëse kanë tokë, në pronësi ose në përdorim, me vendndodhje në nënqarkun fqinj, të cilët sigurohen në mënyrë të detyrueshme, për barrë lindje, për pensione dhe për sigurim shëndetësor;

e) pjesëtarët e familjes, që nuk trajtohen me pagë, por që punojnë e bashkëjetojnë me të vetëpunësuarin, të cilët sigurohen në mënyrë të detyrueshme, në nivel minimal, për barrë lindje, për pensione dhe sigurim shëndetësor;

ë) personat mbi 16 vjet, që punojnë në ndërtime të ulëta vetjake, sipas përcaktimeve në paragrafin e fundit të nenit 20 të ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar, për të cilat jepet leje nga komuna ose bashkia, të cilët sigurohen në mënyrë të detyrueshme për sëmundje, barrë lindje, pensione, aksidente në punë e sëmundje profesionale, papunësinë dhe sigurim shëndetësor;

f) personat fizikë, të vetëpunësuar në veprimtari, tregtare apo shërbimi, ambulante, që kanë mbushur moshën 16 vjeç, kur nuk janë të siguruar si punëmarrës a si të vetëpunësuar në veprimtari ekonomike të vijueshme, sigurohen, në mënyrë të detyrueshme, vetëm për degën e pensioneve. Si persona të vetëpunësuar në veprimtari tregtare apo shërbimi, ambulante, janë personat, që vetëpunësohen në veprimtari:

- i) të përkohshme e të vijueshme, por pa një vendqëndrimi apo shërbimi, të përcaktuar;
- ii) të përkohshme e me ndërprerje gjatë javës, por pa një vendqëndrimi apo shërbimi, të përcaktuar;
- iii) të vijueshme, në veprimtari tregtare në tezgë, pa një vendqëndrim të përhershëm ose në mjete, që lëvizin;
- iv) të vijueshme, në veprimtari transporti, me ndërprerje gjatë javës.

2. Personat me të ardhura të rregullta nga pronësia, mbi 16 vjeç, të cilët paguajnë kontribut të detyrueshëm vetëm për sigurimin shëndetësor.

3. Nxënësit e shkollave të mesme apo profesionale dhe studentët, për kohën e programuar të praktikës mësimore, të cilët sigurohen nga punëdhënësi vetëm për aksidentet në punë, për aq kohë sa është përcaktuar në kontratën e lidhur ndërmjet subjektit dhe institucionit përgjegjës.

4. Shtetasit e huaj dhe personat pa shtetësi, të punësuar, punëdhënës ose të vetëpunësuar, në subjekte të regjistruara për efekte fiskale në Republikën e Shqipërisë, mbrohen dhe sigurohen, në mënyrë të detyrueshme, sipas përcaktimeve në pikën 1 të këtij kreu.

5. Nga mbrojtja dhe siguri i detyrueshëm përjashtohen shtetasit e huaj:

a) që punojnë në subjekte, të cilat, në bazë të një marrëveshjeje, nuk kanë detyrimin për t'u regjistruar në organet tatimore shqiptare;

b) pjesëtarë të subjekteve të huaja, që nuk kanë detyrimin për t'u regjistruar në organet tatimore shqiptare, të cilët vijnë në Shqipëri të punojnë në një punë apo shërbim të caktuar, sipas një kontrate shërbimi, të lidhur me një subjekt të regjistruar në organet tatimore shqiptare, i cili nuk është degë apo njësi e subjektit kontraktor.

c) me rezidencë të përhershme jashtë territorit të Shqipërisë, të cilët kanë veprimtari të regjistruara në emrin e tyre, në të dyja shtetet, do të jenë subjekt i mbrojtjes dhe sigurimit të detyrueshëm në atë vend ku kanë rezidencën, vetëm nëse shteti i tyre ka një marrëveshje në fushën e sigurimeve shoqërore me shtetin shqiptar;

ç) që janë të përjashtuar nga pagimi i kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore, në Shqipëri, në bazë të një marrëveshjeje, të lidhur me shtetin shqiptar.

II. PAGA BRUTO DHE PAGA MINIMALE

1. Paga bruto, për efekt të llogaritjes së kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore, është paga e caktuar sipas legjislacionit në fuqi ose në kontratën e punës, sipas rastit, me kohë ose vëllim pune, dhe shtesat e tjera, me karakter të përhershëm, që lindin nga marrëdhëniet e punës. Paga bruto evidentohet në listëpagesën tip, e cila është dokumenti bazë për evidentimin e kontributeve individuale.

Në pagën bruto, për efekt të llogaritjes së kontributeve të sigurimeve, shoqërore e shëndetësore, nuk përfshihen:

a) përfitimet që punëmarrësi merr, në mënyrë të përhershme, nga fondet e sigurimeve shoqërore;

b) kompensimet nga rritja e çmimeve;

c) dhuratat në të holla, që nuk kanë karakter të përhershëm dhe të përgjithshëm;

ç) të ardhurat nga detyrimi ushqimor, të caktuara me vendim gjykate;

d) vlera e antidoteve, që punëdhënësi jep në natyrë për personat e punësuar, sipas legjislacionit në fuqi;

dh) shpërblimet me karakter jo të përhershëm, të lejuara në mbështetje të legjislacionit në fuqi, shpërblimet nga fondi i veçantë, për rastet e fatkeqësive në familje, për sëmundje të gjata, për dëme, në raste fatkeqësish të mëdha natyrore, e për veprimtari të shquara;

e) vlera e shpenzimeve, për të punësuarit, që kryejnë veprimtari jashtë qendrës së banimit;

ë) honoraret apo shpërblimet e tjera, të kësaj natyre, që nuk kanë lidhje me marrëdhëniet aktuale të punës.

2. Paga minimale mujore, për efekt të llogaritjes së kontributit të sigurimeve shoqërore e shëndetësore, nga data 1.7.2008 e në vazhdim, të jetë jo më pak se 14 830 (katërmbëdhjetë mijë e

tetëqind e tridhjetë) lekë, ndërsa paga maksimale mujore të jetë 74 150 (shtatëdhjetë e katër mijë e njëqind e pesëdhjetë) lekë.

Për të punësuarit, marrëdhëniet e punës të të cilëve rregullohen me ligjin nr.7961, datë 12.7.1995, “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, paga minimale mujore, për llogaritjen e kontributeve, është ajo e përcaktuar nga Këshilli i Ministrave, në zbatim të nenit 111 të ligjit të sipërpërmendur, e cila nuk mund të jetë më e ulët se paga minimale, e përcaktuar në paragrafin e parë të kësaj pike.

III. LLOJET, SHUMA DHE SHPËRNDARJA E KONTRIBUTEVE

Në mbështetje të neneve 9, 10, 14 e 90 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të neneve 8, 9, 10, 11 e 12 të ligjit nr.7870, datë 13.10.1994 “Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, llojet dhe masa e kontributeve përcaktohen, si më poshtë vijon:

1. Shuma minimale mujore e kontributeve, për të gjitha degët e sigurimit, për periudhën nga data 1.7.2008 e në vazhdim, të jetë 4 879 (katër mijë e tetëqind e shtatëdhjetë e nëntë) lekë. Kontributi minimal mujor, sipas degëve të sigurimit, të jetë:

	%	në lekë
Dega e sigurimit të sëmundjeve	0.8	119;
Dega e sigurimit të barrë lindjeve	2.3	341;
Dega e sigurimit të pensioneve	23.9	3 544;
Dega e sigurimit të aksidenteve dhe sëmundjeve profesionale	0.5	74;
Dega e sigurimit të papunësisë	2.0	297;
Sigurimet shëndetësore	3.4	504.

2. Në ndryshim nga pika 1 e kreut III, shuma minimale mujore e kontributit të sigurimit shëndetësor për të vetëpunësuarin dhe për pjesëtarët e familjes, të patrajtuar me pagë, të jetë 7% e pagës minimale mujore, e barabartë me 1038 lekë.

3. Kontributi i detyrueshëm për sigurimet shoqërore e shëndetësore, për të punësuarin, duke filluar nga data 1.7.2008 e në vazhdim, të jetë 32.9 për qind e pagës bruto mujore, sipas listëpagesës, ku pjesa e punëdhënësit të jetë 21.7 për qind dhe pjesa e të punësuarit 11.2 për qind. Kontributet të llogariten nga punëdhënësi, mbi pagën bruto, të përcaktuar në këtë vendim. Ai mban nga paga e punëtorit 9.5% për sigurim shoqëror, dhe 1.7%, për sigurim shëndetësor, dhe së bashku me pjesën e tij 20 % të pagës, për sigurim shoqëror, dhe 1.7 % të pagës, për sigurim shëndetësor, e deklaron dhe e paguan në llogarinë bankare, të përcaktuar për kontributet.

4. Kontributi i detyrueshëm për sigurimet shoqërore e shëndetësore, për të punësuarit me kontratë pune, që zgjat më pak se 87 orë në muaj, duke filluar nga data 1.7.2008 e në vazhdim, të jetë 30.1 % të pagës bruto, sipas listëpagesës, ku pjesa e punëdhënësit të jetë 19.1 për qind dhe pjesa e të punësuarit 11 për qind, por jo më pak se niveli minimal i pagës bruto, të përcaktuar për llogaritjen e kontributit.

5. Kontributi i detyrueshëm për sigurimet shoqërore e shëndetësore, për të punësuarit me kontratë pune, që zgjat më pak se një javë, duke filluar nga data 1.7.2008 e në vazhdim, të jetë 3.9 % të pagës bruto, sipas listëpagesës, ku pjesa e punëdhënësit të jetë 2.2 për qind dhe pjesa e të punësuarit 1.7 për qind, por jo më pak se niveli minimal i pagës mujore, të përcaktuar për llogaritjen e kontributit.

6. I vetëpunësuarit, i vetëpunësuarit në ortakëri, i vetëpunësuarit, që punëson të tretë (me përjashtim të të vetëpunësuarit në bujqësi), duke filluar nga data 1.7.2008 e në vazhdim, paguan për vete një kontribut të detyrueshëm, për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, në masën 33.2 për qind (26.2% sigurim shoqëror dhe 7% sigurim shëndetësor) të pagës mujore minimale, prej 14 830 (katërmbydhjetë mijë e tetëqind e tridhjetë) lekësh, të barabartë me 4924 (katër mijë e nëntëqind e njëzet e katër) lekë në muaj. Këta persona llogaritin kontributet për vete dhe për pjesëtarët e familjes, që nuk trajtohen me pagë dhe i paguajnë në llogarinë bankare, të përcaktuar për kontributet.

7. I vetëpunësuarit, për pjesëtarët e familjes së tij, mbi 16 vjeç, që nuk trajtohen me pagë, por që punojnë e bashkëjetojnë me të ligjërisht (me përjashtim të të vetëpunësuarit në bujqësi), duke filluar nga data 1.7.2008 e në vazhdim, paguan kontribut të detyrueshëm për sigurimet, shoqërore dhe shëndetësore, në masën 33.2 për qind (26.2% sigurim shoqëror dhe 7% sigurim shëndetësor), të pagës

mujore minimale, prej 14 830 (katërbëdhjetë mijë e tetëqind e tridhjetë) lekësh, e barabartë me 4924 lekë në muaj.

8. Kontributi i detyrueshëm për sigurimet shoqërore e shëndetësore, për personat, që kryejnë ndërtime të ulëta vetjake të të tretëve, sipas përcaktimeve në paragrafin e fundit të nenit 20 të ligjit nr.8438, datë 28.12.1998, duke filluar nga data 1.7.2008 e në vazhdim, do të jetë i njëjtë si edhe për të punësuarit e tjerë. Kontributet llogariten dhe paguhen në komunë ose bashki nga personi, i cili ka marrë lejen e ndërtimit.

9. Personat e vetëpunësuar në veprimtari tregtare apo shërbimi, ambulante, sipas përcaktimeve në këtë vendim, nga data 1.7.2008 e në vazhdim të deklarojnë dhe paguajnë kontribut minimal mujor, në shumën 1000 (një mijë) lekë.

10. Personat mbi 16 vjeç, me të ardhura të rregullta nga pronësia, e që nuk janë të punësuar diku tjetër, duke filluar nga 1.7.2008 e në vazhdim, të paguajnë kontribut vetëm për sigurimin shëndetësor, në masën 7 për qind të pagës mujore minimale, prej 14 830 (katërbëdhjetë mijë e tetëqind e tridhjetë) lekësh.

11. Të vetëpunësuarit në bujqësi, nga data 1.7.2008 e në vazhdim, të derdhin kontribut vjetor për sigurimet shoqërore, në masën 12 000 (dymbëdhjetë mijë) lekë, me përjashtim të të vetëpunësuarve, që banojnë në rrethet Bulqizë, Dibër, Gramsh, Has, Kolonjë, Kukës, Librazhd, Malësi e Madhe, Mat, Mirditë, Pukë, Skrapar, Tepelenë dhe Tropojë, për të cilët masa e kontributit vjetor është 7800 (shtatë mijë e tetëqind) lekë.

12. Të vetëpunësuarit në bujqësi, nga data 1.7.2008 e në vazhdim, të derdhin kontribut mujor, për sigurimet e detyrueshme shëndetësore, në masën 5 për qind të shumës 5600 (pesë mijë e gjashtëqind) lekë në muaj, për zonat fushore, ndërsa në rrethet Bulqizë, Dibër, Gramsh, Has, Kolonjë, Kukës, Librazhd, Malësi e Madhe, Mat, Mirditë, Pukë, Skrapar, Tepelenë dhe Tropojë, kontributi është në masën 3 për qind të shumës 5600 (pesë mijë e gjashtëqind) lekë në muaj.

IV. PROCEDURAT PËR REGJISTRIM

1. Subjektet, përpara fillimit të veprimtarisë ekonomike edhe për efekte të pagesës së kontributeve të sigurimeve shoqërore shëndetësore, regjistrohen në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, sipas procedurave të përcaktuara në ligjin nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, në organet tatimore apo në organet e pushtetit vendor, në përputhje me detyrimin për regjistrim, të përcaktuar në aktet ligjore dhe nënligjore, në fuqi.

2. Punëdhënësit dhe personat e vetëpunësuar, që e fillojnë veprimtarinë për herë të parë, brenda 20 ditëve nga data e regjistrimit, sipas procedurave të përcaktuara në pikën 1 të këtij kreu duhet të paraqesin në agjencitë e sigurimeve shoqërore një kërkesë për pajisjen e të punësuarve me numrin e sigurimit shoqëror. Numri i sigurimit shoqëror jepet nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, pas paraqitjes së kërkesës, sipas formularit tip.

3. Bashkitë ose komunat, që japin lejen për një ndërtim të ulët vetjak, në çastin e dhënies së lejes dhe në bazë të dokumentacionit të paraqitur, regjistrojnë veprimtarinë në emër të marrësit të lejes, i cili me fillimin e punimeve, detyrohet të deklarojë punëmarrësit, të paraqesë listëpagesën mujore dhe të paguajë kontributet.

4. Personat e vetëpunësuar për herë të parë, në veprimtari tregtare apo shërbimi, ambulante, paraqesin, në agjencitë e sigurimeve shoqërore, kopjen e certifikatës së identifikimit të personit të tatueshëm dhe kërkesën për t’u pajisur me numrin e sigurimit shoqëror. Regjistrimi bëhet sipas procedurës së përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave.

5. Të vetëpunësuarit në bujqësi regjistrohen në agjencitë e sigurimeve shoqërore, pas paraqitjes së certifikatës së gjendjes civile dhe të njërës nga aktet e mëposhtme:

- Vërtetimin e pronësisë mbi tokën, lëshuar nga zyra e regjistrimit të pasurisë së paluajtshme, të komunës ose bashkisë;

- Aktin noterial, që vërteton tjetërsimin e pronës (p.sh. qiramarrje etj.). Në çdo rast, aktet e mësipërme duhet të jenë të shoqëruara me vërtetimin e lëshuar nga komuna, ku cilësohet se personi ushtron veprimtari, bujqësore/blektorale.

6. Të vetëpunësuarit në bujqësi paguajnë kontributet, për sigurimet shoqërore e shëndetësore, për vitin në vazhdim, pavarësisht nëse janë të pasiguruar për vitet pararendëse. Periudhat, për të cilat nuk janë paguar kontributet, nuk njihen si periudha sigurimi.

7. Nuk është i detyrueshëm sigurimi dhe nuk mund të llogariten detyrimet e kontributeve e të

kamatëvonesave për pjesëtarët e familjeve bujqësore, të vetëpunësuar në bujqësi, për periudhën që përfitojnë ndihmë ekonomike, sipas ligjit nr.7710, datë 18.5.1995 “Për ndihmat dhe përkujdesjen shoqërore”. Periudhat, për të cilat nuk janë paguar kontributet, nuk njihen periudha sigurimi.

V. PAGESA E KONTRIBUTEVE

1. PAGESA e kontributeve dhe e interesave të lidhura me to kryhet nga punëdhënësit dhe nga të vetëpunësuarit, sipas afateve të përcaktuara me ligj. Dokument bazë për pagesën e tyre është deklarata, njoftim i rivlerësimit dhe çdo dokument tjetër ligjor, i miratuar për këtë qëllim.

2. Punëdhënësi bën sigurimin e punëmarrësit, duke filluar nga dita e fillimit të punës, sipas përcaktimit në kontratën e punës apo në aktin e emërimit dhe vazhdon të paguajë kontribute gjatë të gjithë kohës, që vazhdojnë marrëdhëniet e punës. Kur fillimi dhe ndërprerja përfundimtare e marrëdhënieve të punës bëhen gjatë muajit, kontributet llogariten e paguhen në bazë të pagës së realizuar gjatë ditëve të punës.

3. Për rastet kur i njëjti person është ekonomikisht aktiv në dy ose më shumë subjekte, pagesa e kontributit është e detyrueshme në çdo subjekt, sipas pagës, por jo më shumë se kontributi maksimal. Rregullat e llogaritjes së pagesës dhe të rimbursimeve të kontributit përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Financave.

4. Të vetëpunësuarit në bujqësi i paguajnë kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore individualisht, një herë në tre muaj. Afati i pagesës së kontributeve është jo më vonë se dita e fundit e muajit të tretë, brenda çdo tremujori kalendarik.

5. Të vetëpunësuarit në bujqësi mund t’i paguajnë kontributet e detyrueshme të sigurimeve shëndetësore, pavarësisht nga pagesa e kontributeve të sigurimeve shoqërore.

6. Instituti i Sigurimeve Shoqërore furnizon punëdhënësit dhe të vetëpunësuarit me librezat e sigurimeve shoqërore e shëndetësore. Punëdhënësi i pajis të punësuarit me librezën e kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore, të cilën e plotëson çdo muaj, në datën e pagesës së pagës mujore. Për të vetëpunësuarit dhe pjesëtarët e familjes, të patrajtuar me pagë, librezat e kontributeve plotësohet dhe vërtetohet nga strukturat vendore, të autorizuar nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore.

7. Për personat e përcaktuar në pikën 8 të kreut III të këtij vendimi, kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, vilen dhe transferohen në llogaritë bankare, të përcaktuara për kontributet, nga bashkitë ose komunat, të cilat administrojnë edhe dokumentacionin përkatës. Procedurat caktohen me udhëzim të Ministrit të Financave.

8. Personat e vetëpunësuar në veprimtari tregtare apo shërbimi, ambulantë pajisen me librezën e kontributit të sigurimit shoqërore, nga struktura e sigurimeve shoqërore, e cila është e detyruar ta plotësojë atë në bazë të kontributeve të paguara. PAGESA e kontributeve bëhet çdo tre muaj, në bazë të të njëjtave rregulla si pagesa e kontributeve nga personat e tjerë, të vetëpunësuar në biznesin e vogël.

9. Në tremujorin pasardhës, të vetëpunësuarit, pjesëtarët e familjes, të patrajtuar me pagë, të vetëpunësuarit në veprimtari ambulante dhe të vetëpunësuarit në bujqësi vlerësohen të siguruar, nëse i kanë paguar kontributet e tremujorit pararendës.

VI. PROCEDURAT E KALIMIT TË KONTRIBUTEVE DHE MBLEDHJA E BORXHEVE

1. Kontributet paguhen në llogaritë bankare, të përcaktuara për këtë qëllim, të çelura në bankat e nivelit të dytë apo edhe nëpërmjet Postës Shqiptare sh.a., për llogari të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, e cila është përgjegjëse për administrimin e këtyre llogarive si për të gjitha llogaritë e tjera për të ardhurat tatimore.

2. Bankat e nivelit të dytë, në fund të çdo dite, raportojnë, në mënyrë të hollësishme, në Bankën e Shqipërisë, për gjendjen progresive të këtyre llogarive, për të cilën njoftohet, nëpërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit, Instituti i Sigurimeve Shoqërore. Procedurat e evidentimit, të njoftimit dhe të kalimit të kontributeve në llogaritë e fondit të sigurimeve shoqërore dhe në fondin e sigurimeve shëndetësore përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Financave.

3. Kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, nga të vetëpunësuarit në bujqësi dhe të siguruarit në mënyrë vullnetare, paguhen në llogaritë bankare apo në zyrat e Postës Shqiptare sh.a., sipas marrëveshjeve ndërmjet tyre dhe Institutit të Sigurimeve Shoqërore.

4. Kontributet e papaguara në afatet e përcaktuara vlerësohen detyrim ndaj fondit të sigurimeve shoqërore.

5. Për subjektet juridike dhe fizike, përveç personave të vetëpunësuar në bujqësi, shumica e detyrimit kontributiv dhe e interesave llogaritet, evidentohet dhe administrohet nga administrata tatimore, e cila është përgjegjëse edhe për vjeljen e detyrimeve të prapambetura, që këto subjekte kanë

ndaj sigurimeve shoqërore. Procedurat e evidentimit dhe të administrimit të detyrimeve të kontributeve të paguara në afat, përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Financave.

6. Për personat e vetëpunësuar në bujqësi, shuma e detyrimit kontributiv dhe e kamatëvonesave llogaritet nga administrata e sigurimeve shoqërore. Dokument bazë për llogaritjen dhe evidentimin e tij është aktdetyrimi tip, ku, përveç të dhënave të tjera, shënohet edhe pronësia mbi tokën, sipas zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme. Aktdetyrimi hartohet nga administrata e sigurimeve shoqërore, jo më vonë se një muaj nga kalimi i afatit ligjor për pagesën e kontributeve. Shuma e detyrimeve për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe kamatëvonesat evidentohen në kontabilitetin e sigurimeve shoqërore.

VII. RAPORTIMI DHE EVIDENTIMI I KONTRIBUTEVE INDIVIDUALE

1. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe degët e saj dërgojnë, çdo muaj, në strukturat përkatëse të sigurimeve shoqërore, në strukturat e sigurimeve shëndetësore dhe në Institutin e Statistikave (INSTAT):

a) Për sigurimet shoqërore:

i) Të dhënat për kontributet dhe interesat e paguara, deri në datën 10 të muajit pasardhës, të muajit kur janë kryer, zyrtarisht dhe në format elektronik, pagesat në llogaritë bankare;

ii) Formularin përmbledhës të listëpagesave, sipas subjekteve, deri në datën 25 të muajit pasardhës, të muajit kur është realizuar, zyrtarisht dhe në format elektronik, pagesa e kontributit;

iii) Listëpagesat origjinale, sipas formatit të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave, deri në datën 28 të muajit pasardhës, të muajit kur është paraqitur deklarata. Për subjektet fizike, për afatin e depozitimit të listëpagesave, shtohen 10 ditë;

iv) Listëpagesat, në format elektronik, dhe përmbledhësja për deklarimin e të dhënave të listëpagesës, sipas afateve dhe përcaktimeve në udhëzimin e Ministrit të Financave;

v) Të dhënat statistikore për numrin e subjekteve aktive, numrin e kontribuesve dhe shumën e kontributeve mujore dhe progresive, sipas formatit të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

b) Për sigurimet shëndetësore:

i) Të dhënat për kontributet dhe interesat e paguara, deri në datën 10 të muajit pasardhës, të muajit kur janë kryer, zyrtarisht dhe në format elektronik, pagesat në llogaritë bankare;

ii) Formularin përmbledhës të listëpagesave, sipas subjekteve, deri në datën 25 të muajit pasardhës, të muajit kur është realizuar, zyrtarisht dhe në format elektronik, pagesa e kontributit;

iii) Të dhënat për kontributet individuale, të paguara nga personat e siguruar. Procedurat e identifikimit të personave të siguruar dhe të pagesave të kontributeve gjatë periudhës caktohen me udhëzim të Ministrit të Financave;

iv) Të dhënat statistikore për numrin e subjekteve të regjistruara dhe numrin e kontribuesve.

c) Për Institutin e Statistikave (INSTAT): të dhënat statistikore për numrin e subjekteve të regjistruara dhe numrin e kontribuesve, sipas veprimtarisë, që ushtrojnë.

2. Strukturat, në varësi të Institutit të Sigurimeve Shoqërore, dërgojnë në strukturat përkatëse të sigurimeve shëndetësore, zyrtarisht dhe në format elektronik, të dhënat për kontributet e sigurimeve shëndetësore dhe interesat e paguara nga personat e vetëpunësuar në bujqësi, deri në datën 10 të muajit pasardhës, të muajit kur është derdhur kontributi.

3. Kur nuk ka të dhëna, për shkak të mosdorëzimit nga tatimpaguesit, të deklaratave apo të listëpagesave, administrimi bëhet në përputhje me përcaktimet e ligjit nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

VIII. SHUMA BAZË E PËRFITIMEVE

1. Në mbështetje të neneve 2, 32, 36, e 48 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, shuma bazë e përfitimit, nga data 1.7.2008 e në vazhdim, të jetë 9515 (nëntë mijë e pesëqind e pesëmbëdhjetë) lekë në muaj.

2. Në mbështetje të nenit 96 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, shuma e përfitimit, për personat, që nuk plotësojnë kushtet për përfitimin e masës së pensionit, të përcaktuar në paragrafin e parë të këtij neni, nga data 1.7.2008 e në vazhdim, është 5200 (pesë mijë e dyqind) lekë në muaj.

3. Në mbështetje të pikës 4, të nenit 27 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, shuma bazë e përfitimit për gratë, të cilat e kanë periudhën e fundit të sigurimit si të vetëpunësuar në bujqësi, nga data 1.7.2008 e në vazhdim,

është 5200 (pesë mijë e dyqind) lekë në muaj.

IX. PAGESA E PËRFITIMEVE

1. Përfitimet afatshkurtra për sëmundje, barrë lindje dhe aksidente në punë e sëmundje profesionale, në favor të të punësuarit, llogariten nga punëdhënësi, ndërsa për personat fizikë, nga strukturat vendore të sigurimeve shoqërore. Fondet për mbulimin e këtyre pagesave transferohen nga llogaritë e sigurimeve shoqërore në llogarinë e personit, juridik apo fizik, ose në llogarinë individuale të përfituesit, pranë bankave të nivelit të dytë, një herë në muaj, pas miratimit nga administrata e sigurimeve shoqërore të listëpagesës. Procedura e kontrollit dhe e miratimit të llogaritjeve përcaktohet me rregullore të Institutit të Sigurimeve Shoqërore.

2. Përfitimet mujore afatgjata u paguhen përfituesve, nëpërmjet Postës Shqiptare sh.a., dhe bankave të nivelit të dytë. Rregullat dhe procedurat e pagesës përcaktohen me marrëveshje ndërmjet palëve.

3. Këstet mujore të pensioneve dhe të përfitimeve të tjera, që llogariten nga administrata e sigurimeve shoqërore, u paguhen përfituesve, në total, në shuma të plota dhjetëlekëshe, duke u rrumbullakosur vetëm shifrën e fundit. Kur shifra e fundit është mbi 5, bëhet 10 dhe kur shifra e fundit është më e vogël se 5, bëhet zero. Rrumbullakimi, sipas rastit, zbatohet në kolonën, ku evidentohet shuma e pensionit.

X. BASHKËPUNIMI NDËRMJET INSTITUCIONEVE

1. Marrëdhëniet administrative e financiare, ndërmjet Ministrisë së Financave, Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Ministrisë së Shëndetësisë, Institutit të Sigurimeve Shoqërore, Institutit të Sigurimit të Kujdesit Shëndetësor, Bankës së Shqipërisë, Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, bankave të nivelit të dytë dhe Postës Shqiptare sh.a. rregullohen me akte nënligjore dhe me marrëveshje të përbashkëta.

2. Procedurat e regjistrimit dhe të pagesës së kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, për kategori të veçanta personash, realizohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, e cila, në varësi të veprimtarisë, ambulatorë apo të veçantë, lidh marrëveshje bashkëpunimi edhe me organe të tjera shtetërore.

3. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor kontrollon edhe dokumentacionin, që vërteton pagimin e kontributeve të sigurimeve shoqërore nga personat, e punësuar dhe të vetëpunësuar në veprimtari transporti. Kjo drejtori nuk do të ofrojë asnjë shërbim, nëse drejtuesit e mjeteve nuk kanë shlyer detyrimet për sigurimet shoqërore dhe ato tatimore.

XI. DISPOZITA TË FUNDIT

1. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Shëndetësisë, Instituti i Sigurimeve Shoqërore, Instituti i Sigurimit të Kujdesit Shëndetësor dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve të nxjerrin udhëzimet e nevojshme, në zbatim të këtij vendimi.

2. Vendimet nr.771, datë 13.11.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, dhe nr.167, datë 29.3.2006 “Për disa çështje në zbatim të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.7870, datë 13.10.1994 “Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”, të Këshillit të Ministrave, shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1.7.2008.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

VENDIM

Nr.1115, datë 23.7.2008

PËR MIRATIMIN, NË PARIM, TË MARRËVESHJES SË FINANCIMIT, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË SPANJËS, NË KUADËR TË PROGRAMIT “NJË OKB”, PËR PROJEKTIN “QEVERISJE EKONOMIKE, REFORMA RREGULLATORE, PJESËMARRJE E PUBLIKUT, SI DHE ZHVILLIMI PRO TË VARFËRVE, NË SHQIPËRI”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 e 7 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998

“Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe të Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin, në parim të marrëveshjes së financimit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Spanjës, në kuadër të programit “Një OKB”, për projektin “Qeverisje ekonomike, reforma rregullatore, pjesëmarrje e publikut, si dhe zhvillimi pro të varfërve, në Shqipëri”, në vlerën 2 097 564 (dy milionë e nëntëdhjetë e shtatë mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë e katër) USD.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM

Nr.1116, datë 31.7.2008

PËR LEJIMIN E KALIMIT TRANSIT TË TRE AUTOKOLONAVE USHTARAKE ITALIANE, PËRMES TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 16, pika 2, 17, 18 e 19 të ligjit nr.9363, datë 24.3.2005 “Për mënyrën dhe procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për dërgimin e forcave ushtarake shqiptare jashtë vendit”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e kalimit transit, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, të 1 (një) autokolone ushtarake italiane, të përbërë nga 3 (tre) automjete dhe 31 (tridhjetë e një) trupa, në itinerarin Porti i Durrësit-Qafë-Thanë në datën 31 korrik 2008.

2. Lejimin e kalimit transit, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, të 1 (një) automjeti ushtarak italian, me 5 (pesë) trupa, në itinerarin Porti i Durrësit-Qafë-Thanë, në datën 1 gusht 2008.

3. Lejimin e kalimit transit, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, të 1 (një) autokolone ushtarake italiane, të përbërë nga 6 (gjashtë) automjete dhe 15 (pesëmbëdhjetë) trupa, në itinerarin Porti i Durrësit-Qafë-Thanë, në datën 3 gusht 2008.

4. Pika e hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë është pika e kalimit të kufirit Porti i Durrësit dhe pika e daljes është pika e kalimit të kufirit Qafë-Thanë.

5. Procedurat për hyrjen, qëndrimin dhe daljen e këtyre trupave në Republikën e Shqipërisë janë parashikuar në marrëveshjen, ndërmjet palëve të Traktatit të Atlantikut të Veriut, për statusin e forcave nënshkruar në Londër, më 19 qershor 1951, të marrëveshjes, ndërmjet shteteve palë në Traktatin e Atlantikut të Veriut dhe shteteve të tjera, që marrin pjesë në Partneritetin për Paqe, përsa i përket statusit të forcave të tyre, nënshkruar në Bruksel, më 10 janar 1994, si dhe të protokollit shtesë, për marrëveshjen, ndërmjet shteteve palë në Traktatin e Atlantikut të Veriut dhe të shteteve të tjera pjesëmarrëse në Partneritetin për Paqe, përsa i përket statusit të forcave të tyre ratifikuar me ligjin nr.8034, datë 22.11.1995.

6. Automjetet italiane, gjatë hyrjes, lëvizjes dhe daljes në/nga territori i Republikës së Shqipërisë, të shoqërohen nga njësi të armatosura të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

7. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1117, datë 31.7.2008

**PËR LEJIMIN E KALIMIT TRANSIT TË DY AUTOMJETEVE USHTARAKE ITALIANE,
PËRMES TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 16, pika 2, 17, 18 e 19 të ligjit nr.9363, datë 24.3.2005 “Për mënyrën dhe procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për dërgimin e forcave ushtarake shqiptare jashtë vendit”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e kalimit transit, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, të 1 (një) automjeti ushtarak italian, me 2 (dy) trupa, në itinerarin Qafë-Thanë-Porti i Durrësit, në datën 31 korrik 2008.
2. Lejimin e kalimit transit, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, të 1 (një) automjeti ushtarak italian, me 2 (dy) trupa, në itinerarin Porti i Durrësit-Qafë-Thanë, në datën 2 gusht 2008.
3. Pika e hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë, në datën 31 korrik 2008, është pika e kalimit të kufirit Qafë-Thanë, dhe pika e daljes është pika e kalimit të kufirit Porti i Durrësit.
Pika e hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë, në datën 2 gusht 2008, është Porti i Durrësit dhe pika e daljes është pika e kalimit të kufirit Qafë-Thanë.
4. Procedurat për hyrjen, qëndrimin dhe daljen e këtyre trupave në Republikën e Shqipërisë janë parashikuar në marrëveshjen, ndërmjet palëve të Traktatit të Atlantikut të Veriut, për statusin e forcave, nënshkruar në Londër, më 19 qershor 1951, të marrëveshjes, ndërmjet shteteve palë në Traktatin e Atlantikut të Veriut dhe shteteve të tjera, që marrin pjesë në Partneritetin për Paqe, përsa i përket statusit të forcave të tyre, nënshkruar në Bruksel, më 10 janar 1994, si dhe të protokollit shtesë, për marrëveshjen, ndërmjet shteteve palë në Traktatin e Atlantikut të Veriut dhe të shteteve të tjera pjesëmarrëse në Partneritetin për Paqe, përsa i përket statusit të forcave të tyre, ratifikuar me ligjin nr.8034, datë 22.11.1995.
5. Automjetet ushtarake italiane, gjatë itinerarit të lëvizjes nëpër territorin e Republikës së Shqipërisë, të shoqërohen nga njësi të armatosura të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.
6. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1118, datë 2.7.2008

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.839, DATË 11.12.2003 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR PAGAT E USHTARAKËVE AKTIVË TË FORCAVE TË
ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lidhja nr.1 “Pagat bazë sipas gradës dhe viteve të shërbimit për ushtarakët aktivë të Forcave të Armatosura”, e përmendur në pikën 1 të vendimit nr.839, datë 11.12.2003 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet buxhetore, që planifikuara për rritjen e pagave, për vitin 2008.

3. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 korrik 2008.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

PAGAT BAZË SIPAS GRADËS DHE VITEVE TË SHËRBIMIT PËR USHTARAKËT AKTIVË TË FORCAVE TË ARMATOSURA

Vitet e shërbimit															
OFICERË	Nën 2	Mbi 2	Mbi 3	Mbi 4	Mbi 6	Mbi 8	Mbi 10	Mbi 12	Mbi 14	Mbi 16	Mbi 18	Mbi 20	Mbi 22	Mbi 24	Mbi 26
Gjen.Lejtnant (Admiral)															151 400
Gj.Major (Nënadmiral)														142 390	145 000
Gj.Brigade (Kundëradmiral)													112 000	114 000	114 000
Kolonel (Kapiten i rangut I-rë)											86 500	88 200	90 000	91 770	93 550
Nënkolonel (Kapitel i rangut II-të)									65 580	66 800	66 800	69 380	70 700	72 000	73 400
Major (Kapiten i rangut III-të)							50 000	51 000	51 900	52 900	53 900	54 900	550 900		
Kapiten (Kapiten lejtnant)				43 340	44 000	44 800	45 550	46 300	46 600	47 000	47 360				
Toger (Lejtnant)			41 500	42 100	42 600	42 980	43 340								
Nëntger (Nënlejtnant)	38 500	39150	39 700	40 400	41 000	41 000									
Vitet e shërbimit															
NËNOFICERË	Nën 2	Mbi 2	Mbi 3	Mbi 4	Mbi 6	Mbi 8	Mbi 10	Mbi 12	Mbi 14	Mbi 16	Mbi 18	Mbi 20	Mbi 22	Mbi 24	Mbi 26
K/Kapter											46 500	47 000	48 200	48 800	49 900
Kapter								38 600	39 800	41 100	42 400	43 900	45 100		
Rreshter						34 900	36 100	38 500	39 700	40 900	41 600				
Tetar				31 550	33 400	33 400	34 000	34 600	35 200	35 900	36 480				
Nëntetar	27 850	28 400	28 980	30 200	32 750	32 750									
Vitet e shërbimit															
USHTARË PROFESIONISTË	Nën 2	Mbi 2	Mbi 3	Mbi 4	Mbi 6	Mbi 8	Mbi 10	Mbi 12	Mbi 14	Mbi 16	Mbi 18	Mbi 20	Mbi 22	Mbi 24	Mbi 26
Ushtar/detar profesionist II	27 000	28 000	28 800	30 100	32 400										
Ushtar/detar profesionist I	25 300	26 500													
USHTARË T E SHËRBIMIT TË DETYRUESHËM E STUDENTË USHTARAKË															
Vitet e shërbimit															
	Nën 2	Mbi 2	Mbi 3	Mbi 4	Mbi 6	Mbi 8	Mbi 10	Mbi 12	Mbi 14	Mbi 16	Mbi 18	Mbi 20	Mbi 22	Mbi 24	Mbi 26
Ushtar rekrut II/Detar II	2 000														
Ushtar rekrut I/Detar I	1 500														
Studentë ushtarak	1 500														

UDHËZIM
Nr.17/1, datë 5.8.2008

**PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR.17, DATË 13.5.2008 “PËR
TATIMIN MBI VLERËN E SHTUAR”**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në zbatim të neneve 35 e 58 të ligjit nr.7928, datë 27.4.1995 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, të ndryshuar”, dhe nenit 1 të ligjit nr.9944, datë 26.6.2008 “Për një ndryshim në ligjin “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, të ndryshuar”, Ministri i Financave

UDHËZON:

1. Në udhëzimin nr.17, datë 13.5.2008 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, pika 9.4 “Furnizimi i karburanteve”, riformulohet si më poshtë:

“9.4 Furnizimi i karburanteve.

a) Regjimi fiskal

Importuesit e prodhuesit vendas të karburanteve (shoqëri anonime) janë furnizues të nivelit të parë dhe furnizojnë me shumicë klientët e tyre (shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar), të cilët më pas, furnizojnë me të njëjtin mall klientët, që normalisht janë konsumatorë finalë.

Regjimi fiskal në këtë rast përcaktohet në mbështetje të nenit 11 të ligjit të TVSH-së. Importuesit dhe prodhuesit që janë furnizuesit primarë konsiderohen si kryesorë, ndërkohë që operatorët (sh.p.k.), të cilët furnizohen prej tyre, konsiderohen si agjentë.

Sipas pikës 1 të këtij neni, furnizimi i karburantit, i kryer nëpërmjet një agjenti (sh.p.k.), i cili vepron në cilësinë e agjentit për një person tjetër, është një furnizim prej kryesorit (sh.a.).

Në këtë rast agjenti luan rolin e ndërmjetësit në tregun e karburanteve midis personit kryesor dhe personave të tretë, klientë të tij.

Agjenti paraqitet si përfaqësues i kryesorit duke kryer një ndërmjetësim, të konsideruar si furnizim shërbimi dhe që është i tatueshëm si i tillë.

Mbi vlerën e tatueshme të llogaritur në doganë për karburantin e importuar nga kryesori, aplikohet TVSH në shkallën tatimore 20%.

Kjo shumë është TVSH e zbritshme për kryesorin dhe është e kreditueshme prej tij brenda përcaktimeve të nenit 33 të ligjit.

Përsa i përket furnizimit të mëposhtëm, personi që është në rolin e agjentit, paraqitet si furnizues i të tretëve, por duke vepruar për llogari të personit kryesor.

Fatura e lëshuar nga kryesori për llogari të agjentit të tij përmban të gjitha të dhënat që duhet të përmbajë një faturë tatimore sipas nenit 36 të ligjit. Çmimi i vendosur në të, është ai i shitjes me pakicë dhe mbi vlerën e tatueshme të çdo furnizimi, aplikohet TVSH në shkallën tatimore 20%. Ajo deklarohet si TVSH e mbledhshme nga personi që luan rolin e kryesorit dhe konsiderohet si TVSH e zbritshme për blerësin brenda përcaktimeve të nenit 33 të ligjit.

Nga ana tjetër për këtë ndërmjetësim që kryhet për llogari të kryesorit, agjenti i faturon atij një shumë që konsiderohet si vlerë e tatueshme e këtij shërbimi (ndryshe komision), e barabartë me vlerën e ndërhyrjes së tij në treg. Mbi të zbatohet shkalla tatimore e TVSH-së prej 20%, e cila deklarohet si TVSH e mbledhshme nga agjenti. Njëkohësisht kjo shumë konsiderohet si TVSH e zbritshme për personin kryesor, si dhe është e kreditueshme prej tij brenda përcaktimeve të nenit 33 të ligjit.

Shembull:

a) Supozojmë që furnizuesi kryesor e karburantit A është importues dhe në muajin maj importon 100 000 litra karburant.

Është llogaritur në doganë që vlera e tatueshme e karburantit të importuar është 8 000 000 lekë. Mbi këtë vlerë importi, aplikohet TVSH me shkallë tatimore 20% dhe konkretisht, vlera e saj është 1 600 000 lekë, e cila është e zbritshme nga kryesori A, brenda përcaktimeve të nenit 33 të ligjit të TVSH-së.

b) Po në këtë muaj bëhet furnizimi i kësaj sasive e karburantit prej 100 000 litra nga kryesori A, me anë të agjentit B, person i tatueshëm ndërmjetës, për llogari të personave të tretë, konsumatorë finalë C.

Është llogaritur që vlera e tatueshme e këtij furnizimi është 12 000 000 lekë (100 000 litra x 120 lekë/litri çmimi i shitjes me pakicë pa TVSH). Mbi këtë vlerë aplikohet TVSH me shkallë tatimore 20% dhe konkretisht vlera e tatimit është 2 400 000 lekë.

Ky furnizim pasqyrohet nga furnizuesi A duke lëshuar faturë tatimore në adresë të blerësit B, agjent i tij. Kjo faturë regjistrohet në librin e shitjeve të kryesorit A, së bashku me TVSH e paraqitur në të, si dhe në librin e blerjeve të B-së, nëse ky është person i tatueshëm dhe është e zbritshme për të brenda përcaktimeve të nenit 33 të ligjit.

c) Ndërmjetësimi i kryer nga agjenti B konsiderohet si furnizim shërbimi prej tij, për llogari të kryesorit A. Për rastin konkret, vlera e shërbimit është 1 200 000 lekë (100 000 litra x 12 lekë/litri pa TVSH). Mbi këtë vlerë aplikohet TVSH me shkallë tatimore 20% dhe konkretisht vlera e tatimit është 240 000 lekë. Këto të dhëna pasqyrohen nga agjenti B, i cili lëshon një faturë tatimore në adresë të kryesorit A.

Kjo faturë regjistrohet në librin e shitjes së agjentit B dhe librin e blerjeve të kryesorit A duke qenë e zbritshme për të brenda përcaktimeve të nenit 33 të ligjit.

b) Detyrime të palëve.

Midis agjentit dhe kryesorit duhet të ekzistojë një marrëveshje lidhur me faktin e realizimit të furnizimit.

Konkretisht kërkohet që:

- të jetë e përcaktuar qartë roli i agjentit, në mënyrë që të kuptohet që agjenti po kryen një furnizim të shërbimit për llogari të kryesorit dhe jo për llogari të veprimtarisë së tij ekonomike;

- të jetë përcaktuar qartë që agjenti nuk është ekonomikisht zotëruesi i mallit, për rastin konkret karburantit, të cilin e ka furnizuar për llogari të kryesorit;

- agjenti nuk mund të furnizojë në një vendndodhje biznesi, mallra të së njëjtës natyrë (p.sh. karburant të llojit D1) të furnizuar nga kryesorë të ndryshëm;

- të jetë përcaktuar qartë që agjenti nuk mund të ndryshojë çmimin e furnizimit të mallit që i është faturuar prej kryesorit;

- konsiderohet shkelje çdo ndryshim nga agjenti i çmimit fillestar me pakicë të faturuar nga kryesori. Përveç vlerësimit të detyrimit tatimor, zbatohet edhe gjobë sipas nenit 116 të ligjit nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

2. Pika 9.5 “Furnizimi i cigareve” riformulohet si më poshtë:

“9.5 Furnizimi i cigareve

Në këtë paragraf, termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:

- “Furnizues kryesorë” konsiderohen importuesit dhe prodhuesit vendas të cigareve.

- “Furnizues të ndërmjetëm” konsiderohen tatimpaguesit që furnizohen me qëllim për të rishitur te furnizues të tjerë të ndërmjetëm dhe/ose te njësitë e shitjes me pakicë.

- “Njësi të shitjes me pakicë” konsiderohen tatimpaguesit që furnizohen për të shitur te blerësit, konsumatorë finalë.

- “Furnizim i parë” është furnizimi që furnizuesi kryesor bën për furnizuesit e ndërmjetëm apo për njësitë e shitjes me pakicë.

- “Çmim i shitjes me pakicë” është çmimi i paguar nga blerësi, konsumator final.

Furnizuesit kryesorë llogarisin TVSH-në mbi vlerën e tatueshme të çdo furnizimi që ato kryejnë.

Vlera e tatueshme e çdo furnizimi, të kryer nga furnizuesi kryesor për të tretët, përcaktohet nga shumëzimi i sasisë së cigareve të shitura, me çmimin e shitjes me pakicë, pa përfshirë TVSH-në.

Furnizimi i cigareve në vazhdim nga furnizuesit e ndërmjetëm, do të konsiderohet jashtë objektivit të TVSH-së dhe këta persona blerës nuk kanë të drejtë të kreditojnë TVSH-në e faturuar nga furnizuesit kryesorë në lidhje me atë furnizim.

Ndërkohë komisioni i përfutur nga furnizuesit e ndërmjetëm është i tatueshëm si furnizimi i një shërbimi kryer prej tyre. Mbi vlerën e tij zbatohet TVSH në shkallën tatimore 20% e cila është e kreditueshme për përfituesin e shërbimit brenda përcaktimeve të nenit 33 të ligjit të TVSH-së.

Nëse tatimpaguesi që merr furnizimin e parë, është tatimpagues i taksës vendore mbi biznesin e vogël (jo tatimpagues i TVSH-së), ai do t'i faturojë furnizuesit kryesor vlerën e ndërhyrjes në treg, pa llogaritur TVSH-në.

Sipas natyrës së transaksioneve e marrëdhënieve tregtare midis furnizuesit kryesor dhe furnizuesve të ndërmjetëm, faturimi bëhet sipas mënyrës së faturimit total të komisionit ose faturimit të fraksionuar të tij.

9.5.1. Faturimi e pagimi total i komisionit.

Sipas kësaj mënyre, furnizuesit të parë i faturohet totali i vlerës së shërbimit të të gjitha hallkave që ndërhyjnë në tregun e cigareve.

Furnizuesi i ndërmjetëm i faturon furnizuesit kryesor vlerën totale që do t'i shtohet produktit, nga ndërhyrja e tij dhe e të gjitha hallkave të tjera të mëpasshme në treg.

Furnizimet e tjera që furnizuesit e ndërmjetëm bëjnë për hallkat e mëpasshme deri te konsumatori final, janë furnizime për të cilat nuk llogaritet TVSH. Furnizimi i cigareve në vazhdim nga furnizuesit e ndërmjetëm, për furnizues të tjerë të ndërmjetëm apo për njësitë e shitjes me pakicë, do të konsiderohet jashtë objektit të TVSH-së. Ky furnizim do të faturohet me çmimin e shitjes me pakicë të cigareve minus vlerën e ndërhyrjes në treg që përfiton furnizuesi tjetër i ndërmjetëm apo njësia e shitjes me pakicë.

Fatura e lëshuar nga furnizuesit e ndërmjetëm do të jetë faturë tatimore, por në kolonën e TVSH-së së saj nuk paraqitet TVSH.

Shembull:

Çmimi i shitjes me pakicë për një paketë cigare të markës Z është 200 lekë.

Rasti i I : Furnizuesi kryesor (X) furnizon personin e tatueshëm D, njësi shitjeje me pakicë.

X do të faturojë për D si më poshtë:

$$166.67 + 33.33 \text{ (TVSH)} = 200 \text{ lekë.}$$

D nuk ka të drejtë të kreditojë TVSH (33.33 lekë).

D do të faturojë për X, vlerën e ndërhyrjes së tij në treg $30 + 6 \text{ (TVSH)} = 36 \text{ lekë.}$

X ka të drejtë të kreditojë TVSH (6 lekë) të faturës së lëshuar nga D për vlerën e ndërhyrjes së tij në treg.

Njësia e shitjes me pakicë e shet një paketë cigare te konsumatori final pa llogaritur TVSH në vlerën 200 lekë.

Rasti II: Furnizuesi kryesor (X) furnizon një njësi shitje me pakicë (D), tatimpagues i taksës vendore mbi biznesin e vogël (jo subjekt i TVSH).

X do të faturojë për D si më poshtë:

$$166.67 + 33.33 \text{ (TVSH)} = 200 \text{ lekë.}$$

D, si tatimpagues i taksës vendore mbi biznesin e vogël, nuk ka të drejtë të kreditojë TVSH (33.33 lekë).

D do të faturojë për X vlerën e ndërhyrjes së tij në treg vlerën 30 lekë, me faturë të thjeshtë tatimore.

Njësia e shitjes me pakicë e shet një paketë cigare te konsumatori final me vlerë 200 lekë.

Rasti III: Furnizuesi kryesor (X) furnizon një furnizues të ndërmjetëm (Y), person i tatueshëm.

X do të faturojë për Y si më poshtë:

$$166.67 + 33.33 \text{ (TVSH)} = 200 \text{ lekë.}$$

Y nuk ka të drejtë të kreditojë TVSH (33.33 lekë).

Y i faturon X të gjithë vlerën e ndërhyrjes së tij në treg dhe të hallkave të mëpasshme dhe mbi këtë vlerë llogarit edhe TVSH : $34 + 6.8 \text{ (TVSH)} = 40.8 \text{ lekë.}$

Y lëshon një faturë tatimore të TVSH për njësinë e shitjes me pakicë (D), në kolonën TVSH të cilës nuk do të ketë TVSH. Fatura tatimore e lëshuar nga Y do të ketë çmimin e shitjes me pakicë të cigareve minus vlerën e ndërhyrjes në treg që do të përfitojë njësia e shitjes me pakicë D ($200 - 30 = 170 \text{ lekë}$).

Njësia e shitjes me pakicë D e shet një paketë cigare te konsumatori final, pa llogaritur TVSH në vlerën 200 lekë.

Rasti i IV: Furnizuesi kryesor (X) furnizon një furnizues të ndërmjetëm (Y1), i cili furnizon një furnizues tjetër të ndërmjetëm (Y2).

X do të faturojë për Y1 si më poshtë:

$$166.67 + 33.33 \text{ (TVSH)} = 200 \text{ lekë.}$$

Y1 nuk ka të drejtë të kreditojë TVSH (33.33 lekë).

Y1 i faturon X : $36 + 7.2 \text{ (TVSH)} = 43.2 \text{ lekë.}$

Y1 i faturon Y2, vlerën 166 lekë (pa llogaritur TVSH).

Y2 lëshon një faturë tatimore të TVSH për njësinë e shitjes me pakicë (D), në kolonën TVSH të cilës nuk do të ketë TVSH. Fatura tatimore e lëshuar nga Y2 do të ketë çmimin e shitjes me pakicë të cigareve minus vlerën e ndërhyrjes në treg që do të përfitojë njësia e shitjes me pakicë D ($200 - 30 = 170$ lekë).

Njësia e shitjes me pakicë shet një paketë cigare te konsumatori final, pa llogaritur TVSH me vlerë 200 lekë.

9.5.2 Faturimi e pagimi i fraksionuar i komisionit.

Sipas kësaj mënyre secila hallkë e tregut të cigareve, i faturon asaj paraardhëse një vlerë të barabartë me shërbimin e kryer nga ndërhyrja në treg.

Shembull:

Furnizuesi kryesor i cigareve “personi i tatueshëm X” është importues dhe, në muajin korrik 2008, importon një sasi prej 3 tonë cigare të markës “Z”.

Mbi vlerën e tatueshme të krejt sasisë së cigareve të importuara, llogaritet dhe paguhet TVSH në doganë, e cila është e zbritshme nga X, brenda përcaktimeve të nenit 33 të ligjit të TVSH-së.

Rasti I: Importuesi X furnizon distributorin Y, ndërmjetës, i cili më pas furnizon shitësin e pakicës P, regjistruar si tatimpagues i taksës vendore për biznesin e vogël.

Veprimi i parë

Importuesi X, furnizon distributorin Y person i tatueshëm, në sasinë prej 20 000 paketa të markës “Z”.

Çmimi i shitjes me pakicë i paketave të markës “Z” është 200 lekë (përfshirë TVSH). Sqarojmë se ky çmim do të zbatohet në të gjitha hallkat e furnizimit.

Furnizimi i cigareve dokumentohet nga importuesi X, me lëshimin prej tij në adresë të distributorit Y, faturë tatimore me TVSH dhe me të dhënat:

Nr.	Emërtimi	Njësia	Sasia	Çmimi/njësi pa TVSH	Vlera e tatueshme	TVSH	Vlera me TVSH
1	Paketa “Z”	copë	20 000	166,7	3 334 000	666 000	4 000 000

Distributori Y nuk ka të drejtë të kreditojë shumën e TVSH-së prej 666 000 lekë, të paraqitur në faturën e lëshuar nga furnizuesi kryesor X.

Të dhënat e kësaj fature, hidhen nga X në librin e shitjeve dhe Y në librin e blerjeve, në kolonën e blerjeve me TVSH jo të zbritshme.

Veprimi i dytë

Distributori Y furnizon tatimpaguesin P, shitës me pakicë, i regjistruar si tatimpagues i taksës vendore për biznesin e vogël.

Ai përpilon për këtë të fundit një faturë tatimore, ku çmimi i shitjes është ai i shitjes me pakicë (200 lekë), por pa zbatuar TVSH në të.

Shitja e cigareve nga distributori Y konsiderohet si shërbim i kryer për llogari të furnizuesit kryesor X dhe ai përfiton nga ky një komision në masën 17 %, i barabartë me vlerën e shërbimit nga Y deri te konsumatorët finalë.

Në vlerën e komisionit, përfshihet TVSH me shkallë tatimore 20%, e cila faturohet nga Y për llogari të furnizuesit kryesor X.

Në rast se gjatë një muaji distributori Y ka shitur 10 000 paketa të markës “Z”, atëherë komisioni për shërbimin e kryer faturohet sipas tabelës më poshtë:

Nr.	Emërtimi	Vlera e furnizuar	% komisionit	Vlera e komisionit pa TVSH	TVSH mbi komisionin 20%	Vlera me TVSH
1.	Shërbim komision	2 000 000	17	283 333	56 667	340 000

Shuma e TVSH-së prej 56 667 lekë, hidhet në kolonën e TVSH-së në shitje të librit të shitjeve nga Y dhe ndërkohë, është e zbritshme brenda përcaktimeve të nenit 33 të ligjit të TVSH-së, për furnizuesin X.

Veprimi i tretë

Shitësi me pakicë P ka shitur të gjithë sasinë mujore prej 10 000 paketa, që i ishin furnizuar nga distributorit Y. Ai përfiton nga Y, një vlerë të caktuar, pra një komision prej 10 % mbi çmimin e shitjes me pakicë, për furnizimet e kryera te konsumatorët finalë.

Për komisionin e përfituar, P do të lëshojë faturë të thjeshtë tatimore, të cilën ia adreson distributorit Y. Kjo faturë regjistrohet në librin e shitjeve të tij(e konsideruar si e ardhur për të) dhe në atë të blerjeve të distributorit Y (e konsideruar si shpenzim për të).

Nr.	Emërtimi	Vlera e furnizuar	% komisionit	Vlera e komisionit
1.	Shërbim komision	2 000 000	10	200 000

Rasti II: Importuesi X furnizon personin e tatueshëm Y, shitës me pakicë, i cili furnizon vetëm konsumatorët finalë.

Veprimi i parë

Importuesi X, po në këtë muaj, furnizon personin e tatueshëm Y, shitës me pakicë, në sasinë prej 20 000 paketa të markës “Z”.

Furnizimi i cigareve dokumentohet nga importuesi X me lëshimin prej tij, në drejtim të personit të tatueshëm Y, faturë tatimore me të dhënat:

Nr.	Emërtimi	Njësia	Sasia	Çmimi/njësi pa TVSH	Vlera e tatueshme	TVSH	Vlera me TVSH
1	Paketa “Z”	copë	20 000	166,7	3 334 000	666 000	4 000 000

Shitësi me pakicë Y nuk ka të drejtë të kreditojë shumën e TVSH-së prej 666 000 lekë, të paraqitur në faturën e lëshuar nga furnizuesi kryesor, X.

Të dhënat e kësaj fature hidhen nga X në librin e shitjeve dhe Y në librin e blerjeve, në kolonën e blerjeve me TVSH jo të zbritshme.

Veprimi i dytë

Shitësi me pakicë Y furnizon klientët e tij, konsumatorë finalë, ku çmimi për paketë është 200 lekë.

Shitja e cigareve nga shitësi me pakicë Y konsiderohet si shërbim i kryer për llogari të furnizuesit kryesor X dhe ai përfiton nga ky një komision, në masën 17 % të totalit të ardhurave përfituar deri te konsumatorët finalë.

Në vlerën e komisionit, përfshihet TVSH me shkallë tatimore 20%, e cila faturohet nga shitësi me pakicë Y, për llogari të furnizuesit kryesor X.

Në rast se gjatë muajit shitësi me pakicë Y, ka shitur një sasi prej 10 000 paketa të markës “Z”, atëherë komisioni për shërbimin e kryer është sipas tabelës më poshtë:

Nr.	Emërtimi	Vlera e furnizuar	% komisionit	Vlera e komisionit pa TVSH	TVSH mbi komisionin 20%	Vlera me TVSH
1.	Shërbim komision	2 000 000	17	283 333	56 667	340 000

Shuma e TVSH-së prej 56 667 lekë, hidhet në kolonën e TVSH-së në shitje në librin e shitjeve nga Y dhe ndërkohë, është e zbritshme brenda përcaktimeve të nenit 33 të ligjit të TVSH-së, për furnizuesin X.

Rasti III: Importuesi X furnizon shitësin e pakicës P, i regjistruar si tatimpagues i taksës vendore për biznesin e vogël.

Veprimi i parë

Importuesi X furnizon shitësin me pakicë P, tatimpagues i taksës vendore, në sasinë prej 20 000 paketa të markës “Z”.

Çmimi i shitjes me pakicë i paketave të markës “Z” është 200 lekë (përfshirë TVSH).

Furnizimi i cigareve dokumentohet nga importuesi X, me lëshimin prej tij në drejtim të shitësit me pakicë P, faturë tatimore me të dhënat :

Nr.	Emërtimi	Njësia	Sasia	Çmimi/njësi pa TVSH	Vlera e tatueshme	TVSH	Vlera me TVSH
1	Paketa “Z”	copë	20 000	166,7	3 334 000	666 000	4 000 000

Të dhënat e kësaj fature hidhen në librin e shitjeve të X dhe, në librin e blerjeve të shitësit me pakicë P.

Veprimi i dytë

Shitësi me pakicë P ka shitur gjatë muajit sasinë prej 10 000 paketa, që i ishin furnizuar nga importuesi X. Ai përfiton nga X, një vlerë të caktuar (komision) prej 17 % mbi çmimin e shitjes me pakicë, për furnizimet e kryera te konsumatorët finalë.

Për komisionin e përfituar, P do të lëshojë faturë të thjeshtë tatimore të cilën ia adreson importuesit X. Kjo faturë regjistrohet në librin e shitjeve të tij (e konsideruar si e ardhur për të) dhe në atë të blerjeve të importuesit X (e konsideruar si shpenzim për të).

Nr.	Emërtimi	Vlera e furnizuar	% komisionit	Vlera e komisionit
1.	Shërbim komision	2 000 000	17	340 000

9.5.3. Rregulla të përgjithshme

a) Furnizuesit kryesorë në varësi të marrëdhënieve që vendosin me furnizuesit e ndërmjetëm të tyre zgjedhin njërin nga dy mënyrat e mësipërme të faturimit, por jo të dy mënyrat njëkohësisht.

b) Çmimi i shitjes me pakicë, sipas çdo lloji të cigareve dokumentohet me anë të një marrëveshjeje me shkrim, ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe furnizuesve kryesorë, bazuar edhe në rezultatet e investigimit të kryera nga administrata tatimore. Marrëveshja publikohet në Buletinin Tatimor të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve. Ajo mund të rinovohet jo më rrallë se një herë në vit, me kërkesën e të paktën njëres prej palëve.

c) Tatimpaguesit që kanë gjendje malli në magazinë deri në hyrjen në fuqi të skemës, e faturojnë atë për furnizuesin e tyre, me çmimin e blerjes. Furnizuesi kryesor e rifaturon këtë sasi ndaj furnizuesve të tjerë, në përputhje me procedurat e parashikuara në këtë udhëzim. Njësitë e shitjes me pakicë, jo subjekte të TVSH, nuk kanë detyrim të faturojnë për furnizuesit e tyre. Gjithë ky proces vazhdon deri sa faturimi përfundon te furnizuesi kryesor.

3. Në pikën 11.2 “Saktësimet”, paragrafi i dytë riformulohet si më poshtë:

“ Një saktësim kryhet kur:

- furnizimi nuk është i njëjtë me atë që ka kërkuar blerësi;
- mallrat janë dëmtuar apo shërbimi nuk është kryer mirë;
- çmimet ndryshojnë për çfarëdo arsye (zbritje për pagesë të menjëhershme etj.);
- rezultoni një diferencë nga konvertimi i monedhës së huaj me monedhën kombëtare (lekë).”.

4. Në pikën 22 “Dënimet” të këtij udhëzimi, nënparagrafët 22.1, 22.2, 22.3, 22.4, 22.5, 22.6 dhe 22.7, shfuqizohen.

5. Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare, ndërsa skema e parashikuar në paragrafin 9.5.1. “Faturimi e pagimi total i komisionit” hyn në fuqi me 1 shtator 2008.

MINISTRI I FINANCAVE

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Zhan d'Ark”, prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", nr.tel: 04 258 472 (Kryeredaktori)
Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2008 është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 7.8.2008
Doli nga shtypi më 8.8.2008

Tirazhi: 3300 copë	Formati: 61x86/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja “Ilar”
Tiranë, 2008

Çmimi 48 lekë